

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XIX i botimit, nr. 222, Prill 2022
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Gazeta "DUKAGJINI" nderohet me çmimin "Hamit Boriçi" ²

SOT NIKAJ-MËRTURI, "PUSHTOI PRESIDENCËN"!



Nderohen personalitete nga Malësia e Gjakovës dhe e Dukagjinit

Sot, me 12 prill 2022, Sh. T. Z ILIR META, priti në shtëpinë unitare të kombit Nikaj-Mërturin së bashku me personalitete të Malësisë së Gjakovës e Dukagjinit.

Me propozimin e Shoqatës Nikaj-Mërtur, sot Presidenti i Shqipërisë Z. ILIR META, ka nderuar disa personalitete të Malësisë së Gjakovës e Dukagjinit me nderimin më të madh, që babai i kombit si personi unitar, jep për personalitetet që kanë bërë histori atdheadashëse, për liri e demokraci, si dhe për personalitetin me kontribute intelektuale e një ³ kohë krizash.

Ora e maleve

"Ora e maleve" po shenonte ditet e fundit për të hapur siparin e festes mbarekombetare në Rozhaje, e mua emocionet sa vinin e më shtoheshin.

Kisha qene në shume veprimtari në vites shqiptare pertej kufirit, por asnjehere në Mal të Zi e per më teper në nje qyetet ku shqipja degjohej pak të flitej.

Kisha degjuar për atdhetarizmin e disa njerezve aty e si në Luftën e Kosoves megjithese nen sundim, kishin pritur në shtepite e tyre dhjetra bashkëkombas të tyre. Kisha dëgjuar për masakrat, vrasjet, dhunimet, e deri te asimilimi i popullsisë në boshnjak, ndaj kureshtjes si ⁴ shtuar edhe emocionit...

Shqipëria në shekullin e XVII, shkollat shqipe dhe kleri katolik përballë sunduesve osmanë

⁸ osmanë

Zbardhet dorëshkrimi i Sospellos, historia e Shqipërisë nën "optikën" e misionarëve katolikë

Në arkivat e shtetit italian gjenden dokumente të vjetra 600 vjeçare për historinë e Shqipërisë, kulturën, shkollat, gjuhën, traditat, e të tjera. Ato janë një minierë e pafundme për studiuesit, për të zbuluar shumë të pathëna dhe për të njohur ende edhe më mirë, historinë shekullore të Shqipërisë. Një dorëshkrim historik i shekullit të XVII, për Shqipërinë, është zbuluar në Bibliotekën e Bashkisë së qytetit të Feros në Itali, të quajtur Biblioteca Civica "Romolo Spezioli". Dorëshkrimi që ka për autor, Fra Giacinto da Sospello, do të publikohet së shpejti në formën...



SHENJAT E SPIKATURA TË ETNISË SË KOMBIT

⁹ TONË

(Prend Buzhala: "SHENJA TË ETNISË", kumtesa dhe ese nga manifestimi "DITA E PLISIT" në tetë edicione, i botuar dhe i financuar nga Shtëpia botuese "ROZAFI", Prishtinë 2021. Libri botohet në 70-vjetorin e lindjes së autorit të librit z. Prend Buzhala)

Prend Buzhala në bashkautorësi me Ismet Krasniqin përgatitën dhe botuan tetë vëllime në tetë edicione...



Gazeta “DUKAGJINI” nderohet me çmimin “Hamit Boriçi”

Unioni i gazetarëve shqiptarë, Qarku Shkodër, në edicionin e pestë të çmimit “Hamit Boriçi”

Pas dy vitesh shkëputje për shkak të pandemisë mbliidhet sërish në edicionin e pestë të tij, Unioni i Gazetarëve Shqiptar në Qarkun e Shkodrës, për ceremoninë e ndarjes së çmimit “Hamit Boriçi” një veprimtari e përvitshme, e cili ka si qëllim evidentimin e gazetarëve të spikatur në fushën e medias. Një organizim solemn që kulmoi me larmishmerinë dhe seriozitetin e tij të pavarur institucional, i cili provoi edhe njëherë vlerën dhe peshën e vet në nivel kombëtar.

Në këtë ceremoni morën pjesë Profesor Hamit Boriçi, Kryetari i UGSH z. Aleksandër Çipa, përfaqësues të institucioneve të Qarkut Shkodër, gazetarë, punonjës të mediave e shumë intelektual të ftuar.

Ceremonia hapi siparin e vet me dorëzimin e titullit “Mirënjohja e Qytetit” Profesorit Hamit Boriçi të dhënë nga Bashkia Shkodër në vitin 2020, të cilin ia dorëzoi Kryetarja e Këshillit të Bashkisë Shkodër, znj. Briselda Kadia, vlerësim të cilin Profesor Hamit Boriçi e pranoi me shumë emocion dhe me një nderim të shprehur ndaj Qyteti të Shkodrës, qytetarëve të këtij qyteti, institucionit të bashkisë e në veçanti për gazetarët, të cilët i quajti kolegë të nderuar.

Po kaq emocionuese filloi edhe ceremonia e ndarjes së çmimeve nga Kryetari i UGSH - Qarku Shkodër z. Gaspër Marku, i cili kërkoi nga të pranishmit një minutë heshtje në kujtim për ish kolegët, të cilët humbën betejën me pandeminë, ishte mirënjohja kolektive e komunitetit të gazetarëve, të cilët edhe në mungesë gjetën vend në kujtimet e gjithsecilit të pranishëm, e që do mbeten gjatë në memorien e tyre dhe gjithë qytetit të Shkodrës.

Në këtë edicion të organizuar në sallën e Qendrës Rinore “Arka-Shkodër”, u ndanë tetë çmime:

-Gazeta “Dukagjini” me motivacionin: “Që prej vitit 2003, kur u botua numri i parë dhe deri më sot kur është në proces numri i 222-të, Gazeta “Dukagjini”, është sistematikisht e pranishme për lexuesin shkodran, atë kombëtar dhe mbarëkombëtar, me botim në letër dhe online. 3077 artikuj cilësorë dhe profesional të botuar në vite nga 575 autor, janë një kontribut me shumë vlerë, jo vetëm për promovimin

e vlerave të pasura historike dhe turistike të Dukagjinit dhe rajonit verior, por edhe të të gjithë vendit në përgjithësi”.

-Alma Mehmetaj me motivacionin: “Gazetare, drejtuese e emisioneve dhe prezantuese e edicionit të lajmeve me aftësi të spikatura profesionale, me një karrierë të gjatë mediatike në TV Rozafa dhe Radio Motiv. Por, në të njëjtën kohë, edhe drejtuese e këtij institucioni në kohë të ndryshme duke dhënë kontributin e saj

kronikat e përgatitura për TVSH-në”.

-Gjon Gjeka-TV A2 CNN me motivacionin: “Korrespondent prej disa vitesh i TV A2 CNN për Shkodrën dhe rajonin verior. I spikatur për lidhjet direkt për ngjarjet më të rëndësishme të kësaj zone. Më herët ka punuar me shumë cilësi edhe në televizionet lokale të Shkodrës në pozitën e operatorit”.

-Dori Gjerga-TV Euronews me motivacionin: “Korrespondent prej disa vitesh

shkodran dhe më gjerë, të cilët pritet të pasohen edhe me botime të tjera, që ai i ka në projekt.

-Tonin Frroku, gazetar dhe drejtues i emisioneve sportive dhe më gjerë, karriera e të cilit nisi rreth 40 vite më parë në qytetin e Shkodrës ku shërbeu për shumë vite me mjaft profesionalizëm. Më pas, edhe pse zhvendoset familjarisht në qytetin e Korçës, ku ka angazhime shumë të rëndësishme mediatike lokale dhe kombëtare, ai asnjëherë nuk e harroi vendlindjen duke vijuar të kontribuojë mediatikisht për Shkodrën dhe rajonin verior.

Emocionet ishin prezentë si asnjëherë tjetër pasi prezenca e Profesorit në panel e bënte këtë ceremoni edhe më dinjitoze dhe motivuese, të cilën nuk nguruan ta shprehin as gazetarët e vlerësuar me këtë emër të madh në fushën e medias shqiptare, siç u shpreh edhe z. Gaspër Marku ku tha se: “Jemi me fat që e kemi akoma në mesin tonë këtë ikonë të gazetarisë shqiptare”.

Përsëritja dhe vlerësimi i z. Aleksandër Çipa ishte mjaft mbresëlënëse dhe motivues njëkohësisht për gjeneratat e reja të gazetarisë dhe gjithë këtë komunitet. Shkodra dhe komuniteti i gazetarëve të Shkodrës janë një referencë e shkëlqyer për gjithë komunitetin e gazetarëve profesionist shqiptar ndaj dua tu falënderoj për punën dhe vullnetin tuaj dhe besoj se është fjala më e çmuar për gjithë këtë ditë po kaq të çmuar, tha në fjalën e tij z. Çipa.

Në këtë aktivitet u bë edhe prezantimi i librit “Xhubleta Pasaportë e Identitetit Kulturor Kombëtar” me autore gazetaren Rita Shkurtaç. Jo thjeshtë për të prezantuar punën e një gazetaresje, por për vlerat që mbart ai material shkencorë dedikuar xhubletës, kësaj pasurie kombëtare, e cila ishte prezent edhe fizikisht, pasi gjatë kësaj ceremonie performuan me veshjet e tyre dy djem e dy vajza nga Gjimnazi “Dodë Kaçaj” Bajzë, të veshur me çakçirë e xhubleta, të shoqëruar nga mësuesja ku-jdestare Florina Laçaj.

Pasuri me vlera Kombëtare e cila së shpejti do hyjë edhe në mbrojtje të UNESCO-os, Trashëgimisë Kulturore Botërore meriton të promovohet sa më shumë, sidomos nga mediat, të cilat me forcën e zërit, fjalës dhe pasqyrimin të vlerave të saj zgjon interesin e turizmit kulturor, ndihmon në ruajtjen, kultivimin dhe trashëgimin ndër breza, tha ndër të tjera znj. Rita Shkurtaç.

Për të pranishmit u shfaq dokumentari me të njëjtin titull “Xhubleta Pasaportë e Identitetit Kulturor Kombëtar”.

I gjithë veprimtaria u mbyll me një koktej dhe shtrëngim duarsh për tu takuar sërish në aktivitete të tjera po kaq të rëndësishme.

Nga Ramazan Çeka, Prill 2022



Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër, z. Hilmi Lakti, duke i dorëzuar kryeredaktorit të gazetës “Dukagjini”, z. Luigj Shyti, çmimin “Hamit Boriçi”

organizativ të këtij institucioni”.

-Sidola Osja me motivacionin: “Gazetare, drejtuese e emisioneve dhe prezantuese e spektakleve televizive me aftësi të spikatura profesionale, me një karrierë të gjatë mediatike në TV1 Channel”.

-Luan Kadia-RTSH Shkodra, me motivacionin: “Gazetar, drejtues i emisioneve dhe prezantues i edicionit të lajmeve me aftësi të spikatura profesionale, prej shumë vitesh në Radio Shkodra dhe në vazhdim edhe në RTSH Shkodra. Në të njëjtën kohë me një kontribut të çmuar në

i TV Euronews për Shkodrën dhe rajonin verior. I spikatur për lidhjet direkt për ngjarjet më të rëndësishme të kësaj zone. Më herët ka punuar me shumë cilësi edhe në televizionet lokale të Shkodrës në pozitën e operatorit”.

-Faik Sadiku, një pasionant i kahershëm i fushës së sportit, por edhe i gazetarisë sportive, i cili edhe pse asnjëherë nuk punoi si profesionist në media, është një penë shumë e vlerësuar nga lexuesit, brenda dhe jashtë vendit. Ajo që e bën të veçantë Faik Sadikun, është edhe botimi i 5 librave për figura të spikatura të sportit



SOT NIKAJ-MËRTURI, "PUSHTOI PRESIDENCËN"!

Nderohen personalitete nga Malësia e Gjakovës dhe e Dukagjinit

Sot, me 12 prill 2022, Sh. T. Z ILIR META, priti në shtëpinë unitare të kombit Nikaj-Mërturin së bashku me personalitete të Malësisë së Gjakovës e Dukagjinit.

Me propozimin e Shoqatës Nikaj-Mërtur, sot Presidenti i Shqipërisë Z. ILIR META, ka nderuar disa personalitete të Malësisë së Gjakovës e Dukagjinit me nderimin më të madh, që babai i kombit si personi unitar, jep për personalitetet që kanë bërë histori atdhedashëse, për liri e demokraci, si dhe për personalitetin me kontribute intelektuale e njerëzore në kohë krizash.

Sot, Presidenti Meta, nderoi me dekorata:

1- Zef Avdia – Gimaj-Shalë, pas vdekjes, me urdhrin “Kalorës i Urdhrit të Flamurit”;

2- Pader Gegë Lumaj-Plan, Pult, pas vdekjes, me urdhrin “Nderi i Kombit”;

3- Jakup Dusha-Hoxhë Dushaj, pas vdekjes, me urdhrin “Nderi i Kombit”;

4- Kolë Progni, pas vdekjes, me urdhrin “Mjeshtër i Madh”;

5- Nikolle Vatnikaj, pas vdekjes, me medaljen “Shqiponja e Artë”;

6- Mjeku Mhill Gecaj, Kryetari i Shoqatës “Nikaj-Merturi”, me urdhrin “Nënë Tereza”!

Shoqata “Nikaj-Mërtur”, me propozimet e pjekura e të matura për personalitete të historisë tonë të djeshme e të sotme, sot padiskutim zënë vendin e parë si krahinë në shkallë kombëtare, duke zotëruar titujt më lartë presidencial; Nikaj-Mërturi- Nderi i Kombit, Shkolla Gjonpepaj-Naim Frashri, e sot erdhi edhe nderimi për kryetarin e shoqatës z. Mhill Gecaj, e plotë burra e gra të nderuara më parë.

Ç ‘është e vërteta Nikaj-Mërturi e meriton vlerësimin, një krahinë kjo indipendente e vitale ndër shekuj,



pasqyrë e fortë e identitetit kombëtar, duke u renditur e para krahinë në shkallë kombëtare me intelektualë.

Mirënjohje për disa President, që po e vlerësojnë Nikaj-Mërturin.

Mirënjohje për Zotin Meta, duke i uruar: Paç faqen e bardhë!

Zoti i bekoftë Nikaj-Mërturasit!

Agron Perbibaj



Ora e maleve

“Ora e maleve” po shenonte ditet e fundit per të hapur siparin e festes mbarekombetare në Rozhaje, e mua emocionet sa vinin e më shtoheshin.

Kisha qene në shume veprimtari në viset shqiptare per te kufirit, por asnjehere në Mal të Zi e per më teper në nje qytet ku shqipja degjohej pak të flitej.

Kisha degjuar për atdhetarizmin e disa njerezve aty e si në Luftën e Kosoves megjithese nen sundim, kishin pritur në shtepite e tyre dhjetra bashkëkombas të tyre. Kisha dëgjuar për masakrat, vrasjet, dhunimet, e deri te asimilimi i popullsisine në boshnjak, ndaj kureshtjes sime i ishte shtuar edhe emocion për të qenë pjese e kesaj veprimtarie, që mblidhte mbarë shqiptarinë në mes të Rozhajës.

Grupi yne nga Shkodra perbehej nga shkrintari Prele Milani, fotografja dhe shkrintarja Rozafa Shpuza dhe une.

Rruga ishte aq e bukur me biseda të

i huaj në vend të vet e pret vellezerit e motrat, mund ta kuptoje ke te ndjesi.

Minutat kalonin e holli i shtepise së kultures po mbushej dalngadale me njerëz, nder to figura të njohura të politikës e artit shqiptar nga mbare viset.

Nderuan veprimtarine Deputete nga Parlamenti shqiptar, keshilltare presidentesh e ambasador, humanisti gjerman Herbert Pubans dhe humanisti i madh nga Kosova Skender si dhe poete nga trevat shqipfolese e nga emigracioni.

Hapja i ishte rezervuar ekspozites fotografike “Shpirti i nje qyteti” nga fotografja shkodrane tashme e njohur në shumë shtete europiane, Rozafa Shpuza, që u prit me shumë vleresime nga të pranishmit.

Më tej festa vazhdoi në sallën e madhe të kinemase me kumtesa, interpretime vargësh e koncert nga folklori.

Biografia e puna e Njeriut të madh Mustafa Melika Kruja erdhi permes nje




kendshme, me pyetje pergjigje per bjeshtet, per vargjet, per librat, per miqte që na prisnin... e here pas here me ndalesa per të fiksuar pamje mahnitese nga aparati i Rozafes.

E biseda sillej e sillej e shkonte aty ku të gjithë e kishim mendjen, tek veprimtaria, që na priste.

Ishte hera e pare per te tre e asnjeri nuk ja shuante dot kureshtjen tjetrit se, si do ishte gjithcka, por diku bashkoheshim të gjithë.

Organizatori ishte nje njeri i madh, që nuk mund të bente veprimtari të vogla e rruga vijonte.

“Ora e maleve” mbahej në Shtepine e kultures Rozhaje dhe që në hyrje organizatori Ali Daci e miqte e tij, te zgjatnin doren me nje buzeqeshje e krenari që kush ndjehet



ligjërata nga stërmbesa e tij,, profesoreshe Ina Melika

Qershia mbi tortë Ansambli “Rugova” dhe grupi i valleve të Rozhajës, që i dhanë atmosferë të mrekullueshme festës.

20 poetë të ftuar për 20 viktimat e vrara në masakrën e Rozhajës, nje rregull i pashkelur per 13 edicione të mbajtura.

Nderim për të rënë e faleminderit pafund organizatorit Ali Daci, për ftesën.

Nje veprimtari, që mund të them më i miri në trojet shqiptare, per nga organizimi, përmbajtja, mikpritja, akomodimi, respekti e gjithcka.

Sot Rozhaja foli shqip!

Bona Mulaj



T'U RRITË NDERA MARK PALNIKAJ, QË UA VOLLE PERËNDIVE MOLLËN E NDALUAR DHE E SOLLE NDER TRYEZAT TONA!

Për këto relacione, kur isha student do kisha vrapsuar pa ndalur këmbëzbathur nga Shkodra në Tiranë. Para do kohe mi solli, dhuratë Dr. Mark Palnikaj çelësi i bravave të ndryshkura arkivore. Pas shqipërimin dhe botimi, për herë të parë pa censurë të disa turrave me dokumente nga arkivat e Vatikanit. Fill pas botimit të relacioneve të Shqipërisë veriore të shekujve XVII-XVIII, miku im zellnik i ndihmuar nga Prof. Zef Gjeta shkopsitën nudo mes nesh arkëzën 369 vjeçare të Dioqezës së Pultit. Shqiptaret qe duan historinë, librin dhe kulturën kanë nder duar kanavetën misterioze e të plotë, të pa shkurtuar, shqip, për shqiptarët. Me këto prurje të pa prajshme Dr. Mark Palnikaj i hapi rruge vetes të qaset në gjirin e lakmueshëm të historisë dokumentare të Dioqezës Pulti dhe birit të tij Dukagjinit të Ri. Jemi lodhur duke u referuar herë pas herë dokumenteve të pjesshme nder relacione të përzgjedhur. Tash e pas pa kurrfarë çësurimi faktet do flasin me gjuhen e tyre pa pyetur edhe pse recituesve dhe besimtarëve të eposit tonë krenar mund të na shkaktojnë edhe dhimbje koke.

1-Relacionet konfirmojnë se Dioqeza e Pulit ka statusin special të dioqezës më të shumëvujatur, më qendresëtare, pse jo martirja e vetme e trevave ballkanike.

2- Nate, natë, vetëm natë pa hanë ishte jeta në Malet e Pultit gjatë gjithë eklipsit shumë shekullor osman.

3- Mjerim, zhele, fatkeqësi dhe uri, në kufijtë e mbijetesës, ishte refreni i jetës pulatike

4-Relatorët ishin misionar të huaj shtegtarë nder malet tona të ashpra. Të alarmuar dhe befasuar deri në kufijtë e habitës informojnë Vatikanin, për gjendjen tmerrësisht dramatike të Dioqezës së Pultit në veçanti, por edhe të Shqipërisë së veriut.

5-Ndonëse tipa të ndryshëm e në mote të ndryshme relatorët në mënyre strikte bëjnë inventarin e objekteve të kultit, gjendjen e mjeruar të tyre, shkatërrimet e osmanëve. Janë shumë të përpiktë me regjistrimin e banorëve e të fshatrave kryesore të Dioqezës. Kanë ndjekur me dhimbje procesin e ndryshimit të strukturës fetare sidomos në Pultin Epërm (Gash e Krasniqe). Relacionet janë të thata, me përshkrime të varfra që nuk të ngjallin ndonjë emocion të veçantë, shumë, shumë larg nga shkrimet e majave të mëvonshme të etërve tanë të mëdhenj françeskan.

6- Shigjetues e gjykues të rreptë e të drejtë, por shpesh here edhe cinik, plot spec. Në fakt relatorët kështu duhet të jenë. Relacioni nuk mund të jetë hartim romantik, por me shifra e fakte reale.

7-Nga relacionet del edhe qarte se kemi të bëjmë me një popull të mjerë pa-

gan, në cilën krishterimi nuk kishte zënë rrënje të shëndetshme. Puliti ishte dhe mbeti një purgator i harruar i ngjuar si anxa në zguar prej otomanëve, i braktisur nga Vatikan madje edhe nga vet Zoti

8- Priftëri, martir të dënuar te jetonin në kisha pa as një orendi, madje me petka leckaman meshe, por edhe prototipa të shëmtuar gjysmën analfabet, dallkaur, ryshfetxhi, që bashkëpunon me turqit, me gra e të dashura. ... Cilësitë e Dom Fran Samerishi. Ky prift është famullitarë i fshati Plandi – I pa ditur, di pak të lexojë dhe aspak te shkruaj, nuk u mëson doktrinën e krishterë besimtarëve, nuk e mbjellë tek ata kurrë fjalën e Zotit. Ka pak devocion Udhëton i armatosur dhe ngjanë si barbar trak.... Gjergj Toliqi apostolik në relacionin e viti 1685 shkruan.... Përveç Pjeter Reçit plak i moshuar dhe gati i matufosur, në gjithë Dioqezën nuk kam gjetur as një meshtar.

9- Relatorët nuk i bëjnë elozhe askujt dhe pak a shumë i përkufizojnë popujt e Pultit se, jetonin në shkujdesje të plote për jetën e përditshme, duke u përzier në çdo lloj poshtërsie dhe ndyrësi, por që mbesin në besimin katolik (Gjykim tepër i rreptë pse jo emocional, parë me syze dogmatike të një shtegtari, që vinte nga Parajsa për një ekskursion të shkurte në ferr). Ky fshikullim e të tjera si ky duhen analizuar qetësisht në kontekst me kohën pasi duhet të jemi racional dhe ruhemi qoftë irritomi apo nga metamorfizmat epike kur shkruajmë e flasin për motin e vjetër.

Ne, si popull vijmë nga një errësi verbuese orientale dhe duhet kohë, duhet luftë pa kompromis dhe dëshirë për tu çliruar nga kjo sëmundje gjenetike. Duke shfletuar ato relacionet krejt të thjeshta para pasqyrës të shfaqet një Shqipëri fushore-kodrinore anarkike, të ndarë në çifliqe, me mendësi kusarë, dembele, renegate e shtruar si bari nënë kose, pa as një ide kombëtare. Në anën tjetër të medaljes, kemi Shqipëri nder male, në liri natyrale ekstreme, në gjendje natyrore të barbarisë, e uritur, ku perënditë polit-eiste janë fisi, krahina, bajraku, krenaria dhe etja e shfrenuar për hakmarrje.

10- Relatorët ngrinin alarmin kundër trashëgimisë së moçme pagane të martesave me kunatat dhe ndikimit oriental osman të mbajtjes së dy grave (kukubi-

nave). Me 1894 shifrat janë kokë shkreta me numra, emra e mbiemra për çdo zone, por këta mësues autokrat të doktrinës së krishterë harrojnë ekzogaminë, që ishte kyçi i ruajtjes genit vital, që ruajti ekzistencën e fisit.

11-Relacionet janë statistika korrekte fetare për famullitë, numrin e banesave, të frymëve, deri për sakramentet, krime

qartë se, Pulti ashtë baba i Dukagjinit. Së paku hapësira e rrudhosur minimalisht nga Qafa e Beshkasit deri ku përfundon Malësia e Gjakovës, sikur historia të mos ishte shkruar siç kanë dashtë fitimtarët duhej të thirret Pul edhe sot ashtu siç është ligjuar në gjitha dokumentet kishtarë, që nga shekulli i VII-të e në vijim.

16- Në djepin e Pultit sot jetojë po thuaj gjithë Malësia jonë alpine. Bijtë Gjoll Sumës, Pep Sumes (Shoshi) pak më pare dhe më pas bijtë e Nikës (Shala) shtegtuan nga Dukagjini i vjetër dhe dyndën në Shalë dhe Shosh duke u bërë zotër të këtyre trevave dhe mbartën me vete emrin Dukagjin si kujtim i vendit prej ka erdhën


17- Relacionet e Dioqezës së Pultit, e tregojnë qartë se Shoshi dhe Xhani janë dy këmbët e Dioqezës martire të Pultit dhe qëndresës për ruajtjen e besimit te vjetër.

Relacionet nuk përputhën as nuk duan të ja dinë me hierarkinë e bajraqeve pjellë e Perandorisë Otomane, prandaj Shoshi dhe Xhani marrin rëndë parësorë mbi të tjerët ashtu si Dushmani ndaj Temalit (bajrak), për të cilin relatorët as nuk duan t'ia dinë hiç.

Në këtë territor deri në vitin 1479 kane qenë pesë që ishin Kiri, Mëgulla, Mauriqi, Artivoja (sot i zhdukur) dhe Varku (Lagje Kotec, fshati Palç i krahinës së Murturit edhe kjo i rrënuar), kujtimi i këtyre qyteteve kështjellarë është përhumur nder ciklonet e mjegullta shekullore. Në këtë territor ka pasur disa kështjella, të cilat administroheshin nga dinastitë feudalë të Spanëve dhe Dukagjineve (Kështjella e Pjeter Spanit në Geghysen, e Lekë Dukagjinit në Shkëmbin e Rajës, Guri Lekës në Shosh e të tjera)

Tu ritë ndera Dr. Mark Palnikaj, që ua volle perëndive mollën e ndaluar dhe e solle nder trevezat tona. Nxënësit, studentet, mësuesit, intelektualët, lexuesit e dashuruar, dhe veçanërisht studiuesit gjeograf e historik kanë brumin e referencave moshatare me shekujt. Ky libër, mbas Biblës, Kuranit është më i pari që duhet në bibliotekat e Dukagjinave. Mjere për ata që nuk e dinë dhe nuk e çmojnë!

Prele Milani



publike e poshtërsi të ndryshme.

12- Të konvertuarit në pjesët skajore V-L të Dioqezës nga të gjithë relatorët njëzëri thirren me emrin Renegat.

13- Relatorët duke qenë klerik të thekur janë treguar indiferent në lidhje me ngjarjet politike-luftarake të atyre viteve, ose na bën të dyshojmë se, nuk ka pas një qëndresë, defekte të organizuar. Tangedialisht janë trajtuar edhe ngjarjet më të rëndësishme si tre herë Djegia Arqipeshkëvisë së Pulti me seli në Shosh dhe krejt krahinës në vitet (1705, 1731 dhe 1761). Nga viti 1653 deri në vitin 1895, Shoshi del se ishte spunza e qëndresës kundra asimilimit.

14- Relacionet flasin me gjuhë të koduar dhe po nuk pate mjaftueshëm bazat e njohurive historike, krijon perceptime të shtrembra në lidhje kohezioni dhe kontekstin e tyre.

15-Relacionet e Dioqezës së Pultit, nuk e thonë, por nga përmbajtja e tyre del e

Vëllimi poetik “ZOTI RRUSH”, poezi nga Prelë Milani

RECENSION

Jo më kot thonë se me tre fjalë një poet thotë më shumë se 300 një njeri i zakonshëm.

Njerëzit avancojnë me fjalën, e përdorin me kujdes duke e vendosur në vendin e duhur, dhe kështu formon dalëngadalë globin e fjalës në duart e tij.

Atë glob, që pasuron mendjet e zemrat e lexuesit, ndaj merr një libër me poezi, lexoje dhe ke për të parë se do t'ju çojë tek e bukura.

Kështu ndodh me brendinë e vëllimit poetik “ZOTI RRUSH”.

Ky vëllim poetik plot sarkazëm godet në mënyrë ironike fenomenet negative në mjediset shqiptare, me poezi, sarkazëm, satirë, i cili brenda këtij vëllimi ka lëvruar shumë stile poetike me tema e brendi të jashtëzakonshme, kështu që nuk mungojnë metaforat pikante, të cilat veçse sa ia shtojnë larminë tekstit, pasi në çdo strofë a poezi përcjell mesazh përmes imazheve dhe simbolikave.

Strukturën e thellë e përbëjnë aspektet e realizuara me shumë kuptim ndaj dhe mesazhi shfaqet si rezultat i asaj që flitet mbi botën dhe mbi elementin kryesorë që është njeriu.

Rrëfimet flasin në mënyrë ndjenjore, por përçon ironi mbi fenomene të caktuara, duke shtuar çështjen e ekzistimit, në kohën bashkëkohore dhe shohim përpjekjen, insistimin e poetit brenda rrëfimit që nuk mbetet vetëm si koncept, por e ndeshim pothuajse nëpër histori të kohës.

Për poetin Prelë Milani të folurit përmes poezisë është akt i të rrëfyerit poetik në tërësinë e organizimit, ndaj e folura merr formën e vazhdueshme dhe të përhershme që në vetvete i drejtohet njeriut, i drejtohet botës, përmes strukturës së rrëfimit ndaj brenda asaj hapësire të lirë materializohet botëkuptimi poetik në planin e zhvillimit është e pakufishme e pambarim, sepse, gjërat dhe ne ekzistojmë pasi po flitet për to, kështu që nxjerrim njohje të reja nga e folura edhe brenda rrëfimit poetik.


Prelë Milani i qaset këtij lloji letrarë në këtë teren të pasur të sfondit popullorë plot humor dhe ushtron gjithë potencialin krijues dhe kultivon atë duke dëshmuar qartë në letërsinë shqiptare.

Ndërtimi i vëllimit poetik vjen si ndërthurje e materies dhe brumit sarkazmë-satirik, dhe nuk kursen as ironinë për fenomene, të cilat pikasin sadopak negativitet, ndaj përbën një autencitet sipërfaqësorë të bagazhit të autorit, madje dhe ironizimit që ju bën rrethanave e rrjedhave në rafinimin artistik të lëndës, që karakterizohet pikërisht si ironizim a

satirizim i rrjedhave shoqërore në mjediset tona si elemente të padisiplinuara në skemat sistimore.

Poeti ven përballë tërë kapacitetin komiko-satirik duke krijuar kështu terrenin infra-strukturorë me mjaft mjeshtri dhe brenda rrethanave.

Poezia e këtij poeti është arti filozofik i ekzistencës ku pikë-mbështetjen e ka tek formulimet mes ironisë e realitetit ku dominon vërtetësia, subjektiviteti krijues udhëhiqet nga urtësia e ligjërit, kthjelltësia e mendimeve, të cilat ndër-



lidhet mes fenomeneve dhe dukurive dhe qartësohet perceptimi i botës, si gjetje mjaft fantastike këto formulime të mrekullueshme poetike.

Kështu që raporti mes imazheve, ndjenjës e mendimeve sikur krijohet brenda nuancave satirike dhe filozofisë dhe fuqizon detajet poetike.

Kush art tjetër do ta kishte kënaqësi të tillë përjetimi estetik e fuqizuar bukur e qartë, plot vizion dhe dinamikë që është mishërim dhe fisnikërim i shpirtit të krijuesit, fuqizon konceptin poetik dhe estetik në rrafshin esencial për jetën e botën.

Kombinon elementet përbërëse, ritmin e figurat brenda raporteve ligjëritore dhe përmes shumë përfytyrimeve, pra lojës analoge dhe kundërvënies.

Ky vëllim poetik me vargje mjaft impresionuese të frymëzuara nga çaste, momente e fenomene të ndryshme, nga ide e fakte njerëzore, janë shenja të veçanta krijuese që prodhojnë figurshmëri dhe realitet jetësorë, më shumë pasion për një poetikë të mirëfilltë e të pasur.

Ky vëllim poetik “ZOTI RRUSH” shtjellon brenda sarkazmës e satirës, ndaj duket ndryshe nga ajo e përditshmja, dhe bindjet e standardizuara.

Pra, autori eksploron në ambiente të njohura ku shquan ngjyrat në diversitet jetësorë dhe në atë reliev që i njeh shtigjet kështu që ka ndërtuar dhe ideo-tematikën e vëllimit.

Shtjellimi shtjellor, materia kompozicionohet, kështu që ‘ZOTI RRUSH’ është dhe prologu që paraprind librit, pra dhe poezia me këtë titull vjen si shtyllë për vëllimin pra fillesa e shtjellimit, pastaj merr dhënë shtjellësia e thurjes së tematikës ndër kapituj.

Ai zbraz bagazhin e tij krijues, gjithë talentin dhe mjeshtërinë e ndërtimit të këtij lloji sarkazmë-satirë.

Vendosë e zhvendosë pozicionet e tyre brenda një lloji balanci të rrjedhave në varg dhe realitetit shoqërorë, duke sajuar raporte e relacione mes tyre, me metodikë performuese me përkushtim në afirmimin e artit letrarë e vlerës mirëfilltë poetike.

Mos'kokçarës i heshtur e fjalëpak / S'gjuajti kurrë me top as me breshëri / Lasgushi, ka qënë një bujk kuprrak / Që mbolli e korri vetëm poezi /

Vargje satirike plot domethënie, thurur bukur dhe në formën metaforike, për këtë karakter të veçantë ku pahëzon shpirtin satirik të shqiptarit me metodikë performuese, me kapacitet të lartë perceptimi e ndijimit të realitetit, kështu që vështrimi shumë dimensional pahëzon mënyrën e veçantë të ligjërit, figurën adapte përmes intonimit dinamik.

Një hero i Balzakut kërkon ta skllavërojë botën, kurse një hero i Destojevskit ta mposhtë atë. Që të dy duan të dalin jashtë të përditshmes, të zakonshmes, që të dy janë të drejtuar si shigjeta nga pafundësia.

Brenda atyre vargjeve të çiltra definohehet muza e ngacmimit, për ta përshkruar atë në formën më të bukur të mundshme dhe mjeshtërisht është mbështjellë tema brenda vargut.

Pikërisht fuqia filozofike në poezi bëhet faktor e ndihem e rezervuar në gjykimin për poezinë në tërësinë e saj dhe duke dalë tek poezia si shprehje e botës emocionale të krijuesit, dhe fantazia për krijuesin është e përafërt me botën reale së cilës i referohet duke krijuar premisa të kapshme logjike për ndjenjën emocionale të lexuesit e shpalosësit të ndjenjës së vargut.

Dua ta theksoj traditën e pasur popullore të zonës prej nga vjen autori, folklorin burimorë të popullit, që padyshim është bazamenti i krijimit të personalitetit.

Lucën e pat vra Sadria / Gjak për gjak shkuan trimat / Për një lakër që hengri dhia / Budallenjtë thyen kaptinat /

Eh jeta, jeta luan me melodinë e saj. Të rrëmben fakti miop e të zhytë thellë në zymtinë e fenomenit e udhëheq në terrenin e mendje- ngushtësisë, duke mos i dhënë qartësi kuptimit të jetës.

Mirësia venitet, inteligjenca tkurret, pasionet udhëhiqen me idiotësi.

Egoja zaptot hapësirat e shpirtit. Retorika neveritëse pjell sherrshinjtë e ju merr mendjen si pjellë e pallogjikshmërisë dhe përmbajtjes.

Sado që ironik duket në vargje mesazhi i poezisë prek një fenomen real e tejet të rëndësishëm të shoqërisë sonë, pa qoftë edhe ato të dhunës.

Ekuivalenca e kësaj metaforike tregon se njeriu ikën nga kjo botë si një tufan që i bie dimri.

Shembujt janë shkolla e qenieve njerëzore.

Pra në këtë shtegtim rrëfimi dëfton se poeti nisat nga njeriu që nuk vlerëson jetën.

Poezitë e këtij vëllimi poetik dëshmojnë besim tek fuqia e fjalës dhe vetëbesimi për ta trasuar tek lexuesi i gjerë.

Së dyti beson imagjinatës, si bazë për artin dhe të qënurit poet.

Poezia e Prelë Milanit është kënga e shpirtit ndaj merr udhë përmes diapazonit dhe mjeshtërisë së fjalës.

Kështu që mesazhi i rrëfimit i përket çështjes së njeriut dhe logjikës së tij.

Ky poet që kultivon dhe emocionon nga fjala e gurrës popullore të mbushullon mendjen, ndaj bëhet shtysë që përshtypjet t'i hedhësh në letër pasi i qëndron mjaft besnik të folurës dhe ambientit ku e kultivon këtë lloj poezie që në ditët e sotme janë të pakët poetët që po e mbajnë gjallë këtë lloj stili në poezi, aq i veçantë dhe i vjetër sa vetë e folura popullore.

Në poezinë e Prelë Milanit, realisht është një dokument i historisë sonë letrare që i përket letërsisë së pasur popullore, pra folklorizmit.

Kërkon të sintetizojë urtinë e popullit me krijimtari imagjinare dhe ngërthen hallkat e qenësishme të historisë dhe shpirtit të tij, gjithashtu kreativiteti artistik, metaforat, figurat a imazhet, i ngre në nivel të avancuar artistik, duke e zgjeruar e pasuruar me ide, ndaj krijimtaria e këtij poeti, ndriçon shpirtin dhe begaton folklorin e letërsisë.

Dhuron buzëqeshje imazheve të jetës me plot hapa të matur e mirë-menduar në udhë optimizmi e përsosmërie, të ndjeshëm shpirtërisht, të bukura apo të hidhura qofshin, ama të vargëzuara në poezi me metafora pikante satirike.

Epo, drita është sunduesja mbi errësirën.

Prenda Sejdia, Lezhë, maj 2021

Të gdhendësh emrin në gurë

Të gdhendësh emrin në gurë do të thotë të përjetësohesh.

E për të ja arritur kësaj duhet besim, forcë, vullnet e këmbëngulje. Duhet me dashtë fortë jetën për vete dhe për të tjerët dhe kjo nuk është e lehtë. Kjo donë shumë mundë e sakrificë. Duhet që jetën me lëshua në dorën e Zotit e me jetua me nder, burri dhe fisnikëri.

Në Dukagjin janë lindë e rrit burra të mençur, trima e fisnik të cilët e rritën shtatin të rrethuar nga bjeshkët e nalta përreth, të cilat disi ta kushtëzonin hapësirën, duke të thanë shiko ka qiella se, atje ka vetëm një Zot. Nga kjo mori jetë dhe Shprehja "Pasha njat Zoti që m ka falë...!" Pra, për dukagjinasin, Zoti është një e i gjithëpushtetshëm. Nga shekulli në shekull ky besim në një Zot e gdhendi thellë në jetën e dukagjinanit se, atë çka Zoti ja ka dhurua, duke ja filluar nga jeta të dashurojë, ta ruaj e ta fisnikërojë.

Ky qe motivi i jetës së një fisi, të fisit Prele Nikë Lucës në lagjen Than, të fshatit Plan, të krahinës së Pultit, i cili nuk u lakua asnjëherë përpara çdo rreziku. Trojet e të parëve, familja e mbi të gjitha feja e Jezu Krishtit ishin mbi gjithçka. Të parët në luftë, të parët në punë, të parët në festa e gëzime bënë që emri i këtij fisi të gdhendej në faqen e historisë, për të mos u shlyer kurrë. Janë 6 dëshmor të Atdheut nga ky fis 3 (vëllezërit Noka e Ndue Prela me djalë Kolë Ndou) në përballjen me forcat Malazeze në Plan, në muajin korrik të vitit 1915 dhe tre të pushkatuar nga diktatura komuniste, vëllezërit Pal e Mark Thani si dhe Zef Toma.

Kalvari i kësaj familje gjatë diktaturës komuniste ka qenë i përgjakshëm e ndër me të radhët në vendin tonë. Nuk mjaftoj pushkatimi i dy akademikeve Pal e Mark Thanit dhe vrasja makaber në kodër të Shëngjergjit i Zef Tomës. Internimet dhe burgosjet e njëpasnjëshme përgjatë gjithë diktaturës ishin të pafundme, plot 120 vite burg për burrat e këtij fisi. Të shpallur të "deklasuar", ju mohoj çdo të drejtë. Përndjekjet, arrestimet, torturat nuk u kursyen pa dallim për burrat e fisit të Prele Nikë Lucës. Me dy vëllezër të pushkatuar Dede Thani, ish prefekti i Tuzit, arrestohet nga qeveria Jugosllave dhe për 18 vite vuajti demin në burgjet e ish Jugosllavisë. Nëna e tij, Katrine Tomja e mbetur ve dhe me jetimë, shpërngulet në Shkodër dhe me fisnikërinë e saj u bë streha dhe mbështetja pothuajse e vetme për të burgosurit e Planit. Ajo ju lante teshat dhe ju jepte ushqimet e sjella nga familjaret këtyre të burgosurve. Shpresa në Zotin se, një ditë djali, Deda do lirohej e do vinte i gjallë dhe shpresonte edhe pse tek ai burg ishte vra në tortura e sipër djali i saj Marku. Ofshante thellë kur dëgjonte nga jashtë se si po torturoheshin të burgosurit e tjerë e lutej në heshtje e thoshte-Mos e paste fatin e Markut tim.

Kulla e Nike e Tome Ndokës u ba objektivi i parë i zonës për spiunet dhe operativat e Zonës. Pas pushkatimit të Zef Tomës dhe arrestimit të Pader Anton Harapit në Plan, arrestohen të gjithë burrat duke ja nisë nga Mhill Nika, që ishte vetëm 14 vjeç. Në këtë kohë Prek



Pesë djemtë e Nik Ndokës: në këmbë Mhilli, Ndoka, e Kola; ulur Gjoka dhe Ndou



Gjelosh Gjoka



Prek Toma, në audienc me Papa Gjon Pali II, në vitin 1985, në Vatikan

Toma arrijnë të këput prangat dhe të arratiset. Pas lirimt Nika vdes pa prituri nga një sëmundje dhe Prela Toma ridënohet përsëri së bashku me djalin e madhe të Nikës-Ndoken, i cili vuajti 18 vite burg të shoqëruara me tortura dhe punë të rënda në miniera dhe në kënetë.

Historia përsëritet, Nana Lulë e mb-

etur ve dhe me jetimë, me djalin Pjetrin edhe nipin Marashin në burg mori lajmin e kobshëm, që nusja Shaqja dhe nipi Nikolla kishin humbur jetën nga një aksident rrugore në fshatin Pog. Me lotët dhe dhimbjen e Lulës bashkohej çudia e jetimeve me babën dhe vëllain në burg. Nana Lulë ndërroj jetë me emrin e Prekës në gojë. Kishte 40 vite, që se kishte marr një lajmë nga i biri, a ishte gjallë apo i vdekur. Persekutimi i kësaj familje e rriti dhe fisnikëroj më shumë këtë fis. Ata besoni në një Zoti, ata besoni në nder e burri. Të kushtëzuar nga çdo anë i mësoj t'i luteshin Zotit shumë dhe të punonin shumë. Duke mos pas asnjë të drejtë ata të drejtën për të jetuar ja dhanë vetes dhe Zoti i ndihmoj të ishin të bashkuar me njëri-tjetrin dhe me miq e dashamirë. Ata e banë gurin të qesh, gurrën e kthyen në dritë. Ndërtuan kullat e djegura nga pushtuesi dhe pushteti, të cilat në 1957 i ndriçuan me llampa elektrike, të parët në Alpet Shqiptare. Kanga e lahute dhe vallja hapte dhe mbyllte festat.

Edhe pse nuk i lejuan të shkolloheshin se ishin të "deklasuar" ata shkollë kishin historinë, urtin, sakrificën dhe dashurin për ta jetuar jetën mirë e bukur e me nder.

Demokracia erdhi e i solli vetë në trojet e veta Prek Tomën, i cili pas shumë vuajtjesh kishte arritur në Amerikë dhe atje së bashku me disa nga dukagjinanit e arratisur, u ba strehë dhe mbështetje për çdo emigrant. Arriti të drejtonte bashkësinë katolik të shqiptareve në kishën e Zojës së Këshillit të Mirë, në Neë York.



Pas audiencës me Papën Gjon Pali II, Prek Toma me Martin Camaj, në këmbë, afër tyre, Atë Danjel Gjeçaj

Bashkëpunonte me Martin Camaj dhe Ernest Koliqin, që demokracia të vinte një ditë edhe në Shqipëri. Pas rënies së diktaturës vjen disa herë dhe viziton familjen dhe vihet, me sa mundësi që kishte për ti ndihmuar.

Demokracia si për të gjithë, por ajo u mjaftua me dhënien e titujve dëshmorë të

atdheut 6 burrave të këtij fisi. Demokrat në shpirt janë në ballë të grevave dhe demonstratave demokratike në vendin tonë. I gëzohen se, tashmë përndjekjet kishin marrë fund, tani mund të merrnin fryme lirisht. Por deri diku kjo frymëmarrje nuk u plotësua, sepse shpejt në ballin e demokracisë u radhitën të shkolluarit e diktaturës dhe përsëri përndjekjet vazhdojnë. Demokracia qenka e karrigeve, të cilat e kalojnë karrigen nga halla tek daja, me kujdesin me të madhe, që të ndershit dhe dukagjinanit të mos filtrojnë. Dhe mjafton të qenurit anëtarë dhe pjesëmarrës në grevat e partisë Demokratike, të Mhillit, Kolës, Gjergjit, që pasohen nga Marashi, Noshi dhe Pjetri e deri tek nipi i kësaj familje, anëtare i Shoqatës Antikomuniste "13 Dhjetori" dhe veprimtar i saj Elzarit Pjetri, që pjesëmarrja në grevat dhe veprimtaritë e kësaj shoqate e penalizoj të vazhdonte fakultetin e Historisë dhe të braktiste ëndrrën e tij për vijimin e karrierës si anëtarë i Forcave të Armatosura të Shqipërisë, të largohet nga vendi. Kjo dëshmon më së miri se, në dej e këtij fisi rrjedhë gjaku i pastër. Si shumë djem e vajza të këtyre familjeve martire të Dukagjinit e me bindje demokratike edhe sot nuk e gëzojnë të drejtën e të integruarit dhe të qenurit në ato poste drejtuese.

Lind pyetja apo e gëzojmë edhe pse jemi 30 vite në pluralizëm, të qenurti të lirë dhe të çliruar nga prangat e diktaturës? Kështu, shumë nga trashëgimtarët e këtij fisi duke pa se vazhdon "përndjekja e tyre" me mall për trojet e veta sot kanë emigruar dhe janë integruar na Evropë, Amerikë dhe deri në Australinë e largët.

Sot, në kujtimin dhe nderimin e të parëve, që e dhanë jetën për Fe e Atdhe,

Armando Rrushaj

Shqipëria në shekullin e XVII, shkollat shqipe dhe kleri katolik përballë sunduesve osmanë

Zbardhet dorëshkrimi i Sospellos, historia e Shqipërisë nën “optikën” e misionarëve katolikë

Në arkivat e shtetit italian gjenden dokumente të vjetra 600 vjeçare për historinë e Shqipërisë, kulturën, shkollat, gjuhën, traditat, e të tjera. Ato janë një minierë e pafundme për studiuesit, për të zbuluar shumë të pathëna dhe për të njohur ende edhe më mirë, historinë shekullore të Shqipërisë. Një dorëshkrim historik i shekullit të XVII, për Shqipërinë, është zbuluar në Bibliotekën e Bashkisë së qytetit të Feros në Itali, të quajtur Biblioteca Civica “Romolo Spezioli”. Dorëshkrimi që ka për autor, Fra Giacinto da Sospello, do të publikohet së shpejti në formën e një libri, nën kujdesin e studiuesit të njohur, Dr. Mark Palnikaj, i cili, pa ndihmën e asnjë institucioni apo organizate, por me të ardhurat e tij, po bën një punë të shkëlqyer kërkimore në arkivat e shtetit italian, për të zbuluar historinë e plotë të Shqipërisë dhe të gjuhës shqipe.

Ky libër vjen me titullin “GIACINTO P. Da Sospello – Relatione Universale dell’origine, e successo della Missione Apostolica de Frati Min.ri Oss.ti Rifor.ti Del serafico P’rè S. Francisco nel Regno d’Albania”, i cili është i ndarë në gjashtë kapituj dhe përshkruan historikun e 16 misioneve fetare, të kryera në shekullin e XVII, që ka qenë pjesë edhe autori i librit. Dorëshkrimi i përket periudhës kohore nga viti 1634 deri në vitin 1650. Fra Giacinto da Sospello ka qenë Vikar Apostolik i Shqipërisë, dhe përshkruan përpjekjet që bënin misionarët katolikë për edukimin fetar dhe social të popullsisë shqiptare.

Ai ka lënë edhe disa dokumente dhe relacione të shkruara në Arkivin e Propagandës Fide dhe në Arkivin Sekret në Vatikan, në Arkivin e Shtetit në Modena dhe në disa arkiva të tjerë, të publikuar një pjesë e tyre nga studiuesi shqiptar, Injac Zamputi, dhe nga studiuesi italian, Lorenzo Taçhella.

Shkollat shqipe, shekulli i XVII

Misioni i klerit katolik shqiptar nuk ishte i ndalur vetëm në edukimin fetar të popullsisë, por, ata janë përpjekur të hapin shkolla për të shkruar dhe lexuar gjuhën shqipe. Pra, shkollat kishin edhe karakter shkencor. Priftërinjtë i hapën shkollat për fëmijët 8 deri 10 vjeç, por edhe më të mëdhenj. Numri i nxënësve që dëshironin të mësonin, shtohet dita-ditës. Sipas të dhënave, priftërinjtë hapën shkolla që datojnë nga viti 1585; në Kurbin më 1632; shkolla e Pllanës dhe të Blinishtit në vitin 1644; shkolla e mesme në Janjevë të vitit 1670; shkolla e Rrjollit, e hapur nga Pjetër Bogdani me mësues Marin Gjini, në vitin 1675; shkolla e Shkodrës, e hapur nga Filipi, nga Shkodra, në vitin 1698, e shumë shkolla të tjera. Në vitin 1703 është mbajtur në Mërq të Lezhës,



Kongresi i Arbërit, ku shënimet dhe vendimet ishin në gjuhë latine, por u përkthyen në gjuhën shqipe në vitin 1706. Frati Françesko Maria nga Leçe, në vitin 1716, kishte botuar Gramatikën e Gjuhës Shqipe, me 270 faqe, dhe fjalorin italisht shqip, e të tjera.

Fretërit kur mbërritën në Shqipëri, në pjesën veriore, u përballën me analfabetizmin dhe varfërinë. Ata kishin një shprehje: “Ah shqiptarëve të varfër, gomari ua

ka ngrënë gërmat!” Një shprehje shumë e përhapur në atë kohë, për kombet që nuk kishin alfabet të tyre. Madje, doktrina e krishterë ishte “mësojuni letra atyre që janë më të aftë, predikoni ato në ditët e festave, dhe festoni mesha gjatë ditëve të javës”. Por nevoja për luftë ishte shumë e domosdoshme, pasi turqit kishin nisur vrasjet dhe persekutimet.

Marrëdhënia e klerit me sunduesit osmanë

Në këtë libër, i cili ka informacione të pafundme për Shqipërinë, përshkruhen edhe marrëdhëniet e klerit me Perandorinë Osmane. Konkretisht, përshkruhet bashkëpunimi i shqiptarëve katolikë me gjeneralin Dalmat në luftë për çlirim kundra turqve. Kleri ka luajtur rol thelbësor në shporjen e osmanëve nga Shqipëria. Në kundërpërgjigje, osmanët kanë kryer vrasje dhe ekzekutime ndaj tyre për të ruajtur pushtetin sundues. Në një nga kapitujt përshkruhet se si disa individë kishin vjedhur vulën e fretërve dhe kishin vulosur dokumente që i kishin hartuar vetë, për të komprometuar dhe penalizuar fretërit në raport me sundimtarët turq.

Kjo bëri që të arrestohen shumë priftërinj dhe paguheshin shumë para për lirin e tyre, edhe pse ishin të pafajshëm. Osmanët kanë kryer ekzekutime dhe vrasje jo vetëm ndaj klerit shqiptar, por edhe ndaj misionarëve të huaj. Sa i takon vrasjeve, dy françeskanët e parë që erdhën në vitin 1636 në Shosh, Pader Kerubino nga Vallebonas dhe Pader Bonaventura nga Pallazuola, u kërcënuan me vdekje dhe u larguan. Në vitin 1644 janë ngulur në hunj të gjallë dy fretër në Shkodër dhe janë vranë dy fretër në Kelmend në buzë të lumit Cem. Nga viti 1620 deri në vitin 1750 janë vranë 11 fretër vetëm në dioqezat e Pultit dhe Shkodrës.

Kapitujt e librit

Libri është i ndarë në 6 kapituj dhe në faqen e parë ka shënimin “Relatione delle missioni dell’Albania”. Më poshtë, titujt e kapitujve janë:

1. Kapitulli i parë me titull: Cap.o P.o Del sito e stato dell’ Albania, sue Provincie e Cristianità.

2. Kapitulli i dytë: Cap.o 2 Della Christianità delli monti d’Albania. Faqe 8.

3. Kapitulli i tretë: Cap.o 3 Dell’origine, qualità e costumi delli Albanesi. Faqe 19.

4. Kapitulli i katërt: Cap.o 4 Della necessità che tiene l’Albania dell’ Apostolichè Missi.

5. Kapitulli i pestë: Cap. 5 Dell’origine delle Miss.ni Apostoliche mandati nel Regno di Albania

6. Kapitulli i gjashtë: Cap. 6 et ultimo Cattalogo delli Miss.rij et Operarij ò Coad.ri che hanno fatticato nella Miss.nè d’Alb.a.

Ky libër është një minierë informacionesh historike. Së shpejti do të publikohet nën kujdesin e Dr. Mark Palnikaj, i cili do të vijë me të tjera zbulime për lexuesit dhe studiuesit. Pra, u jepet mundësi edhe studiuesve të tjerë, që të hulumtojnë mbi këto dokumente të vjetra origjinale.

Përgatiti Eneida Jaçaj

SHENJAT E SPIKATURA TË ETNISË SË KOMBIT TONË

(Prend Buzhala: "SHENJA TË ETNISË", kumtesa dhe ese nga manifestimi "DITA E PLISIT" në tetë edicione, i botuar dhe i financuar nga Shtëpia botuese "ROZAF", Prishtinë 2021. Libri botohet në 70-vjetorin e lindjes së autorit të librit z. Prend Buzhala)

Prend Buzhala në bashkautorësi me Ismet Krasniqin përgatitën dhe botuan tetë vëllime në tetë edicione të Manifestimit "Dita e Plisit". Prend Buzhala duke qenë pjesë e organizimit dhe pjesëmarrjes së tij në tetë edicionet e kaluara, me kumtesat e tij hartoi librin, me titull shumë domethënës "Shenja të etnisë". Një ndër këto shenja të etnisë është Plisi. Me të drejtë në 70-vjetorin e lindjes së Prend Buzhalës, shkrimtari Agim Gjakova, në mes tjerave tha: "Prend Buzhala, ky burrë i fisëm me shkrimet e tij ia dha të gjitha ngjyrat kombëtare plisit...".

Prendi, në libër i paraqet kumtesat dhe shkrimet tjera kushtuar plisit, pasi që manifestimi nga ideatori dhe organizatori është paraparë të mbahet në Oda, Kulla, Kështjella (vende qëndresa) dhe vende tjera, që kanë një histori trashëguese nga e kaluara apo siç e thotë autori i këtij libri "u zhvilluan në ambiente kullash memoriale... edhe temat e kumtesave u përzgjedhën në këtë mënyrë".

Ndër temat, që u trajtuan në libër, duke u bazuar në manifestimin "Dita e Plisit", janë:

PLISI SHQIPTAR SHENJË E AUTOKTONISË ETNIKE, POEZIA DHE KËNGA KUSHTUAR PLISIT TË BARDHË, TRAJTIMI I PLISIT NË VEPRAT MONUMENTALE, DEKALOG PËR PLISIN SHQIPTAR, LETËRSIA DHE PLISI SHQIPTAR, PLISI DHE KULLA, LETËRSIA KUSHTUAR KULLËS, SEMANTIKA ETIMOLOGJIA E FJALËS PLIS, PLISI DHE ARMATKULTURA E MBAJTJES DHE PËRDORIMIT, KULTI I NDERIT NË TRADITËN SHQIPTARE, KULTURA E DËGJIMIT NË TRADITËN POPULLORE, NJË DITËLINDJE QË SHËNON EDHE NJË JUBILE KULTUROR, PLISI I BARDHË AI FLAMUR SHPIRTI, PLAKU I SOTEM SHQIPTAR, KULLA TEMPULL SHQIPTAR, PLISI-MONUMENT I YNI NACIONAL, LAHUTA DHE PLISI, DITA E PLISIT PORTRETI I POPULLIT TONË, PROFILI I TIJ ETNIK SHPIRTËROR E MATERIAL E DERI TE HOMAZHET KUSHTUAR PLISBARDHËVE QË RRUGËTUAN MENE E TANI NUK JANË NË JETË.....

Prend Buzhala në librin "Shenja të Etnisë", i cili përbëhet prej 215 faqeve, paraqet edhe karakterin e qëllimit të Manifestimit "Dita e Plisit" si: Qëllimi i manifestimit "Dita e plisit" është, që të arrihet në nivel kombëtar të organizohet një datë me emrin "Dita e Plisit, në të gjitha trojet shqiptare dhe diasporën shqiptare.

Shenja e Etnisë e quajtur Plis, duket i bardhë prej leshi, të cilën pellazgët, Ilirët e më vonë shqiptarët e përdorën për ta mbuluar kokën. Quhet plis, sepse është e krijuar prej leshit të deles së bardhë. Dita

e plisit ka qëllim t'i përfshijë të gjitha llojet e plisave, që i bartin shqiptarët në zona të ndryshme shqiptare edhe ato kapele që nuk e kanë ngjyrën e bardhë.

Plisi është simbol dhe mbulesë tradicionale e kokës ndër shqiptarë. Mbase, ky ishte dhe mbeti si një lloj elementi identifikues i shqiptarëve, por edhe një lloj arme më e fuqishme për të rezistuar kundër tentimeve asimiluese e shkatërruese ndaj tyre.

"Dita e Plisit" mbahet në kohën kur çdo ditë e më shumë po hiqet nga përdorimi e së shpejti do të mbetet në muzeun etnografik, kjo është arsyeja e organizimit të manifestimeve kushtuar plisit për ta prezantuar te gjeneratat e reja: le ta trashëgojnë edhe ata këtë simbol pellazgo-iliro-shqiptar dhe t'i zgjatet jeta këtij simboli me rëndësi kombëtare. Duke e bartur gjeneratat e reja sot sigurisht kësaj shenje të etnisë e quajtur plis te populli edhe te gjeneratat e ardhshme i zgjatet jeta edhe një shekull.

Shenja të etnisë paraqiten në manifestimin "Dita e Plisit" paraqitën kumtesa, program kulturo artistik, folklorik, anekdota e poezi, gjer më tani në tetë edicionet e kaluara të manifestimit "Dita e Plisit" janë shkruar mbi 200 poezi tematike kushtuar Plisit, po ashtu janë botuar tetë libra, tetë edicione në tetë vëllime me mbi një mijë foto kolor. Të gjitha këto shkrimtari Prend Buzhala bukur i shtjellon në librin e tij "SHENJA TË ETNISË".

Projekti "Dita e Plisit" apo si që i ka dhënë titullin e librit Prend Buzhala "Shenja të etnisë", realizohet prej vitit 2014, për çdo vit organizohet në vende të ndryshme:

1- Edicioni i parë i manifestimit kulturor u mbajt në Kullën-muze të Gjon Nikë Gjergjaj në Krushevë të Vogël-Kline më 15 TETOR 2014.

2- Edicioni i dytë "Dita e Plisit" u mbajt në Kullën e Zenel Hasan Berishës në fshatin Dobërdol të Klinës më 31 tetor 2015.

3- Edicioni i tretë u mbajt më 29 tetor 2016 në kullën e Vehbi Ukë Isufit- Qendra Rajonale e Turizmit në Junik

4- Edicioni katërt i manifestimit kulturor "Dita e Plisit", u mbajt më 28 tetor 2017, në Kullën Muze të Azem e Shotë Galicës në Galicë.

5- Edicioni pestë (faza e parë) "Dita e plisit, kumtesa, orë letrare tematike kushtuar plisit, program kulturor-artistik që u

mbajt më 30 qershor 2018, e shtunë, në ora 11.00, në Odën e Daut Feratajt - Uçë (Istog).

Edicioni pestë (faza e dytë), manifestimi "Dita e Plisit" u mbajt në Kullën Muze të Heroit kombëtar "Zahir Pajaziti" në Orllan të Besianës në Llapin heroik, më 4 gusht 2018

Edicioni pestë (faza e tretë), manifestimi

liktet e vjetra e t'i dorëzojnë në muzeun më të afërt, me zhdukjen e relikteve, zhduket edhe etnia kombëtare.

Sigurisht autori e paraqet ruajtjen dhe kultivimin e një relikti kombëtar siç është plisi, njohja dhe kultivimi i zejës plis punuese, zanat që po shuhet si dhe afirmimi dhe ruajtja e rrobave kombëtare, prezantimi përmes ekspozitave e publikimi i tyre. Të njihen gjeneratat e reja me mënyrën e jetesës së popullit shqiptar gjatë viteve e shekujve të kaluar si dhe ngritja e vetëdijes së qytetarëve për t'i tubuar reliktet e vjetra e t'i dorëzojnë në muzeun më të afërt për tua zgjatë jetën në ruajtjen e kultivimin e krijimtarisë shpirtërore e materiale, kultivimin e dashurisë ndaj plisit, si që thotë autori "shqiptari dallohet kudo me plis, se vetëm shqiptarët e kanë bartur plisin".

Pajisja me njohuri e masës mbi reliktin e plisit dhe paraqitja e të dhënave shkencore e vjetërsia e plisit, e bën të qëndrueshëm jo vetëm me vite, po me shekuj, këtë qëllim e ka edhe autori të shprehur në librin "Shenja të Etnisë". Për t'u kultivuar në kulla, muze, oda, për ta jetësuar lahutën, çiftelinë, rrobat kombëtare, folklorin, bisedat në oda, këngë maje krahu, anekdota, barsolet, humor, këngë dasdash, këngë në rast fejesash apo të përcjelljes së vajzës, poezi tematike, kumtesa, ushqime tradicionale e deri të pritja e përcjellja e miqve, ose më mirë me thënë- kultivimi i vlerave materiale e shpirtërore nga trashëgimia jonë e pasur, "thjesht për t'ua shkundur pluhurin gjërave të vjetra me vlerë, në këtë rast kryefjala është PLISI", vështrim i autorit të tekstit.

Për t'u arritur niveli i duhur shkencor gjithëherë angazhohen etnografët, etnomuzikologët, profesionistët nga lëmi i trashëgimisë materiale e shpirtërore. Qëllimi final është të caktohet një datë kur do të festohet dita e plisit nga të gjithë shqiptarët kudo qofshin. Dhe librin e përfundon autori duke treguar se, rrënjësia e traditës na përcjell mesazhin universal, secili popull i ka rrënjët e tilla dhe nga ato nuk heq dorë e veçmas ne shqiptarët kemi arsye të veçantë të mos heqim dorë nga një trashëgimi materiale e shpirtërore e pasur nëpër shekuj, e larë me gjak, por e mbrojtur maksimalisht.

Ismet KRASNIQI
8 prill 2022



mi "Dita e Plisit" u mbajt në Kullën Muze të Heroit kombëtar "Isa Boletini" në Boletin - Mitrovicë, më 27 tetor 2018.

6- Edicioni i gjashtë (faza e parë), u mbajt në Zym të Hasit manifestimi "Dita e Plisit", më 30 prill 2019.

Edicioni gjashtë (faza e dytë) u mbajt më 29 qershor 2019 në Jezerc të Ferizajt.

7- Edicioni i shtatë, një manifestim mjaftë dinjtoz "Dita e Plisit" dhe promovimi i librit "Dita e Plisit", në bar-restorantin "Ujëvara e Mirushes", në afërsi të Klinës, u mbajt më 19 shtator 2020, në rrethana pandemie Covid 19

8- Edicioni i tetë (pjesa e parë) u mbajt manifestimi "Dita e Plisit", në fshatin Stankaj në Rugovë, më 30 qershor 2021

Edicioni i tetë (pjesa e dytë) e manifestimit "Dita e Plisit", u mbajt në fshatin Prugovc të Prishtinës, më 24 tetor 2021

Të njihen gjeneratat e reja me mënyrën e jetesës së popullit shqiptar gjatë viteve e shekujve të kaluar si dhe ngritja e vetëdijes së qytetarëve për t'i tubuar re-

Talent i madh, artist mjeshtër!

Matjanët janë të njohur për punë, art e kulturë. Janë dhe patriotë të mëdhenj, intelektualë me botë të pasur shpirtërore, artistike e kulturore. Mbresa e realitete të tilla kemi shumë, aq sa faqet e këtij shkrimi nuk më mjaftojnë.

Ikli Kadri Punavija është i njohur tashmë për shpirtin e tij artdashës, për talentin e tij muzikor, si mjeshtër i madh i interpretimit në lauri e çifteli. Janë të dëgjuar instrumentistët Ibrahim Minxhozi, Shaqir Hazizi, Xhavit Dishani, Shaban Cibaj, Avni Hoxha e Bajram Doda në çifteli, Ymer Nelaj në fyell e kavall, Behar Nelaj dhe Adriatik Aliaj në bilbil, Hajrulla Ceni e Qamil Beshku në lauri, Xhevat Lishi e Isuf Gjoka në dajre, Enver Kurti në lodër e të tjerë, për mjeshtërinë e interpretimit në Mat e në tërë Shqipërinë. Pas tyre janë të rinjtë në orkestrën popullore e folklorike të Ansambllit "Mati", pa përmendur dhjetëra të tjerë të talentuar në çdo njësi administrative të Matit. Nuk mund të rrih pa folur për një orkestrinë popullore, e drejtuar nga mjeshtëra dhe dirigjentët e pasionuar Munir Shehu, Naim Gjoshi, Ymer Nelaj e të tjerë. Por ndër shumë e shumë instrumentistë të talentuar matjanë, po shkruaj për njërin prej tyre, i njohur në Mat e Klos, në tërë Shqipërinë, Kosovë e më gjerë, në skena koncertesh folklorike, festivale lokale e kombëtare, fitues i sa e sa mirënjohjeve, diplomave e çmimeve artistike, instrumentistin virtuoz të çiftelisë, fyellit baritor e laurisë së rrallë, Ikli Kadri Punavija.

Ikliu, u lind më 10 mars të vitit 1990, në qytetin e Burrelit. Prejardhjen familjare e ka nga fshati Mallunxë, njësi administrative Lis. Prindërit Kadri e Lule rritën shumë fëmijë, Iklin bashkë me vëllezërit Altin, Arjan, Armand, Roland, Andi dhe motrën Etlevë.

Në fis, kushëriri i tij, Isuf Punavija, i ka rënë fyellit dhe ka marrë pjesë në Shtëpinë e Kulturës Burrel. Edhe Lulzim e Haxhi Punavija u kanë rënë instrumenteve popullore. Ndërsa daja Osman Hamit Kola ka qenë aktivizuar me bandën frymore të qytetit Burrel.

Ikliu, talentin e shfaqti që në moshë të re, duke i rënë çiftelisë, me të cilën nisi rugën e gjatë të karrierës së artistit. Vete shprehet me shpirt muzikanti se, u është mirënjohës mjeshtërve Ymer Nelaj, Qamil Beshku, Qendrës Kulturore të Fëmijëve dhe orkestrinës popullore të Ansambllit Folklorik "Mati". Është i thjeshtë, djalë i zgjuar, artist i madh. Kujtimet dhe mbresat nga jeta si artist i ka të shumta.

Në vitin 2001 instrumentisti i ri, Ikli Punavija, nisi aktivitetin për herë të parë në Shtëpinë e Pionierit, Burrel, duke mësuar çiftelinë nga Artisti i Merituar, Ymer Nelaj. Për herë të parë doli në skenë në vitin 2002 në festën e 31 Korrikut. Dy vjet më vonë, në maj 2004, konkurroi në Festivalin Mbarëkombëtar në Fushë Arës, ku u vlerësua me çmim të parë si instrumentist. Në qershor të 2004-ës mori pjesë në koncertin e organizuar në Tiranë nga Shoqata Artistike "Mati", ku ishte e

ftuar dhe këngëtarja Feritë Kurti. Në maj të vitit 2005 shkoi në festivalet ndërkom-bëtare të Antalias dhe në Ankara të Turqisë, me Qendrën Kulturore të Fëmijëve të Burrelit, ku u vlerësuan me diplomë dhe kupë festivali. Në maj 2006, së bashku me grupin e Qendrës Kulturore të Burrelit, ishte në festivalin folklorik të instrumenteve popullore të Gjirokastrës.

Pas kthimit nga ai festival, Ikli instrumentist i lindi ideja që të mësojë dhe një tjetër vegël muzikore popullore, laurinë. Punoj me lauritarin e shquar, Qamil Beshku. E mësoi mirë dhe me interpretimin e disa motiveve matjane u paraqit për vit të ri në ekranin e Mat TV, duke interpretuar në çifteli, fyell, bilbil e lauri. Pas mësimit të laurisë, me ndihmën e instrumentistit Qamil Beshku, nisi t'u mësojë çiftelinë një grupi fëmijësh në mënyrë vullnetare dhe të palodhshme. Qëllimi ishte që të mos humbte çiftelia te brezat e ardhshëm. Në vitin 2007 instrumentisti Ikli Punavi-



ja mori pjesë në Festivalin Kombëtar të Rapsodëve dhe Instrumentistëve Popullore të Lezhës, ku u vlerësua me certifikatë nderi.

Ikli ishte një mësues i mirë. Në grupin me 10 fëmijë, instrumentistë të vegjël, u mësoi instrumentet popullore për të ripërtërirë e çuar më përpara kulturën e pasur matjane. Që atëherë ky artist i ka shtuar jetës pasione të mëdha.

Në mënyrë të vazhdueshme ka marrë vlerësime dhe është bërë objekt i shkrimeve kulturore në gazeta e revista të kohës. Certifikata, mirënjohje dhe çmime për pjesëmarrje në festivale folklorike dhe interpretime në instrumente popullore i janë dhënë:

- Në Lezhë më 21 qershor 2007
- Në Burrel, viti 2008
- Në vitin 2009 nga Agjencia "Karbashi"
- Nga FFK i Gjirokastrës, shtator 2009
- Më 24 shkurt 2009 nga Ansambli "Shqiponja e Dukagjinit" Gjakovë
- Në Lezhë, qershor 2010 nga FFT Kombëtar i Rapsodëve dhe Instrumentistëve Popullore
- Më 14 mars 2011 Ansambli "Visaret e Kërrabës"
- Më 2 prill 2011 në Takimin e Parë të Lauritarëve, organizuar në Mat, bashkë

me çmimin e parë

- Qershor 2012 në Festivalin e Alpeve "Peja 2012" bashkë me çmimin e dytë

- Më 31 korrik 2013 për pjesëmarrje në festimet jubilarë të 70-vjetorit të kryengritjes matjane

- Më 30.11.2013 me rastin e 45-vjetorit të krijimit të orkestrinës popullore të Ansambllit "Mati"

- 25 maj 2013 në Bujanoc për pjesëmarrje në Manifestimin Tradicional "Ditët e komandant Lleshit"

- 30 nëntor 2013 në takimin e dytë të lauritarëve, Mat

- Më 25 prill 2013 Shoqata "Shqipëria" në Greqi

- 2 qershor 2017 OJQ "Ardhmëria" Gjakovë, bashkë me Çmimi "Grupi më i kompletuar"

- korrik-gusht 2017 Plavë-Guci nga Tahir Gjonbalaj

- 9 shtator 2017 "Muza Poetike Budiane" Burrel



- 13 maj 2017 në Rahovec

- Më 13 maj 2017 në Dejnë Rahovec, bashkë me çmimin "Instrumentisti më i mirë"

- Në tetor 2017 "Nga Tradita" në Top Estrada TV Tetovë

- Më 2 qershor 2018 "N 'Oden e Malësisë së Gjakovës" bashkë me çmimin e dytë

- Në Lezhë më 26 tetor 2018,

- Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike në Rahovec,

- Më 2 mars 2018, nga SHKA "Anadri"

- 2 janar 2018 nga Grupi i Valleve të SHKA "Ardhmëria" Gjakovë

- Më 23 shtator 2018 në Tiranë nga "Jehona Shqiptare"

- 7 shtator 2018 nga "Muza Poetike Budiane" Burrel

- Më 16 shtator 2018 nga SHKA Caralukë-Malishevë

- 15 shtator 2018 nga komuna Gjakovë

- 14 shtator 2019 nga "Muza Poetike Budiane" Burrel

- 12 prill 2019 nga "Zëri i Vëllazërisë, Pejë

- Më 9 tetor 2019 nga SHKA Caralukë-Malishevë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Ndreshaj" • Më 28 mars 2019, SHKA "Ardhmëria" Gjakovë • në Pejë më

12 prill 2019 nga Shoqata e Vëllazërisë

- Më 18 janar 2020 në Prizren, edicioni i dytë, i ftuar si instrumentist përshëndetës në Manifestimin Poetik "Ibrahim Rugova"

Gjithashtu instrumentisti Ikli Punavija, i vlerave autoktone, ka qenë personazh i shkrimeve të botuara në gazeta e revista:

- Në gazetën "Mati", korrik 2008, shkrimin "Ambasadorët e vegjël të Matit"; tetor 2008, në shkrimin "Artist me të ardhme"; prill-maj 2009, në shkrimin "Në agun e një jete plot shpresë", gusht 2009; "Pse shqetësohet Ikli Punavija"; shtator-tetor 2009, në shkrimin "Shkollë e madhe e folklorit shqiptar"; qershor-korrik 2010 shkrimin "Shoqatë e re kulturore"; nëntor-dhjetor 2010 "Shpirt e zemër sollën në Mat"; nëntor 2012 në shkrimin "Promovim vlerash kulturore ballkanike dhe evropiane"; dhjetor 2017, në shkrimin "Kultivues të folklorit klosjan në Tetovë"; dhjetor 2018, "Familja



Punavija, bazë dhe kontribut në LNÇ"; nëntor 2019 në shkrimin "FestFolk Klosi 2019", meritë e artistëve popullore. • Në revistën "Gjurmë të shpirtit shqiptar", dhjetor 2009", në shkrimin "Gjithmonë me perlat e saj"; kurse në "Emathia" nr. 3, viti 2009, në shkrimin "Sukses i folklorit matjan në Mal i Zi"; nr. 1, viti 2011, në shkrimin "Na bashkoi lauria"; nr. 3 e vitit 2013 në shkrimin "Lauria e Matit, instrument i rrallë". • Buletini "77 News" në vitin 2012 në informacionin për organizimin e Festivalit Folklorik Mbarëkombëtar në Kampusin "Vitrina"; në vitin 2013 në rubrikën "Drejtësi dhe Solidaritet". • Në gazetën "Nacional", 6 gusht 2017, për shkrimin "Kënga dhe vallja shqipe i bashkoi shqiptarët në Vuthaj"; më 14 tetor 2018 në shkrimin "Vlerë e trashëgimisë së pashterur folklorike". • Tetor 2019 në gazetën "Dukagjini", "Nderi i Kombit", për "FestFolk Klosi 2019". • Po në tetor 2019, në gazetën "Rruga e Arbërit" në shkrimin "FestFolk Klosi 2019", veprimtari e rëndësishme e trashëgimisë shpirtërore".

Nga Hamdi Hysuka

Historia e familjes ÇEKA (SUMMA)

Vijon nga numri 220

2 PERSONALITETE TË NJOHURA TË FAMILJES

Lidhjet e familjes SUMMA kanë qenë të shumëllojshme dhe këtu mund të përmendim një dokument të Propaganda Fide të vitit 1854, në të cilin jepet një dëshmi për Pjetër Summën, i cili prej shumë vitesh ka ushtruar në Venedik detyrën e agjentit të Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide, shërbim që është ushtruar mbi 13 pesëvjeçarë, pra rreth 65 vjet nga njerëz të familjes. Dokumenti është firmosur nga Kardinal Fransoni në Romë, më datë 6 tetor 1854:

“Dëshmojmë, e vërtetojmë kujt do ti përkasë se z. Pjetër Summa ka disa vjet që ushtron në Venedik, plot zell besimin e pa interes të Agjentit të Kongresionit të Shenjtë të Propagandës Fides, shërbim tue që në tashma 13 pesëvjeçarë që ushtrohet me të njëjtën lavd prej njerëzve të së njëjtës familje. Gjë për të cilën tue e pasë lypë i sipërthanuni z. Summa që ti jepet një vërtetim, me mjaft kënaqësi po ia përmbushim kërkesat e tij të drejta.”

Romë, prej Propagandës, më 6 tetor, 1854.

E. T. Kardinal Fransoni - Prefekt
Ab. Barnoba Seg.

Aktiviteti i familjes u shtri edhe në fushën arsimore. Meqenëse nxënësit e shkollës Gjergj Benusi u shtuan shumë në vitin 1856, pasanikët e Shkodrës bënë një mbledhje në dyqanin e Ejëll Çekës për të biseduar mbi themelimin e një shkolle popullore duke vendosur që të thërrisnin mësues nga Trieste apo Venediku.

firmosur nga Hecquardi:

“Në Konsullatën Franceze në Shkodër vërtetojmë se zotëri Filippo Summa, shtetas otoman, lindur dhe banues në Shkodër është i rregjistruar në numrin 2 në rregjistrin e veçantë për të huaj, mbajtur nga kjo konsullatë në bazë të dispozitave të marrëveshjes të përmbajtur në traktatet ndër-mjet Francës dhe Portës së lartë Otomane. Me besën e dhënë dhe fjalën ne i japim atij këtë dhuratë për ti shërbyer aty ku të jep të drejtë.”

Shkodër, 08 shkurt, 1854

Ndërsa dokumenti tjetër i jepet Mikel Summa nga Ministria e Jashtme Franceze në vitin 1895, firmosur nga presidenti francez i asaj kohe Felix Fauer:

“Presidenti i Francës me propozim të Ministrisë së Jashtme të Republikës Franceze dekreton një medalje prej ari, lëshuar z. Mikel Summa për kthyes dhe ndihmës i Konsullit të Francës në Shkodër, Albania për shërbimet e bëra për interesa franceze nga viti 1856 deri më 1895.”

Firmosur më 23 prill, 1895

Familja Çeka i forcoi pozitën politike, ekonomike dhe sociale me një dokument, i cili ndodhet në AQSh, pasqyruar në librin e Ardian Popojanit “Firmat tregtare Çoba-Bianku” (1795-1912), libër i përgatitur nga shtëpia botuese “Pegi”, në vitin 1998, ku thuhet se misionarët françeskanë, kur ndaleshin në Shkodër për nevojat e veta, deri në vitin 1861, vinin në shtëpitë e më të parëve, pasanikëve shkodoranë, ku disa familje me leje mbanin altar në dhomat e vogla të shtëpive. Në shekullin XVII ishin shtëpitë e Çobës, Çekës, Llupit e të tjera, ku kryheshin ritet fetare pa u shqetësuar nga administrata turke e asaj kohe.

e tij), ndërsa për Gjystinë Çeka, nun ka qenë punonjësi i kësaj konsullate Albert Loffon si dhe Dava Bib Doda (motra e Preng Pashës). Në këtë dokument jepen dhe të dhëna për meshtarët, të cilët kanë pagëzuar gjithë pjesëtarët e familjes Mikel Çeka (Summa).

Pjesëtarë të familjes Çeka janë dalluar edhe në fushën e muzikës. Kështu, babë dhe djalë, Gaspri dhe Engjëlli kanë marrë pjesë në grupet e asaj kohe me shokë të tjerë muzikante. Është mjaft kuptimplotë një foto e vitit 1900 me një grup muzikantesh, nga muzeu Marubi Shkodër, si dhe një violinë, e cila është përdorur nga Engjëlli, prodhim i Stradivarit. Kënga shkodorane “Sa ma shpejt ma vune kamën” është kompozuar nga Engjëll Çeka.

Falë gjendjes shumë të mirë financiare, familja Çeka ndërtoi një shtëpi të madhe me një sipërfaqe ndërtese rreth 290m² me dy kate, me oborr përpara dhe mbrapa. Sipas burimeve gojore, shtëpia është ndërtuar afro 250 vjet më parë nga dy Ustadharë dibranë, usta Jashar Lleshi dhe usta Jashar Xhani. Krahas shtëpisë tonë, vlen të thuhet se edhe disa familje të fisit Summa janë vendosur në këtë zonë me shtëpi dhe oborr.

Afër shtëpisë është edhe një sipërfaqe toke (bahçe) rreth 12 dynym, në të cilën kohët e fundit, rreth vitit 2005 kemi ndërtuar një shkollë private 9-vjeçare “Miqësia”, e cila nga ana mësimore administrohet nga Flora Çeka (bashkëshortja ime) dhe Ervin Çeka (djali i dytë i familjes sonë).

Me vendim të Rektoratit të Universitetit Shtetëror Tiranë, nr. 6, datë 15.01.1963 shtëpia e Filip Çeka, krahas me disa shtëpi të tjera në Shkodër është shpallur monument kulture i kategorisë I. Gjatë periudhave të ndryshme janë kryer restaurime të ndryshme, por duke ruajtur fizionominë e saj të vjetër.

Këto fakte tregojnë mbi aktivitetin patriotik, historik, arsimor, fetar të pjesëtarëve të familjes Çeka (Summa).

Në nderim të familjes Çeka, Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, ka përfshirë edhe një pjesëtar të familjes (Filip Çeka) në një rubrikë të veçantë, ndërsa në fjalorin enciklopedik të hapësirës shkodorane, hartuar nga Zenepe Dibra, ka një rubrikë prej dy faqesh për familjen Çeka.

3 VEPRIMTARIA PATRIOTIKE E FAMILJES

Udhëheqësit e jetës patriotike shqiptare i vazhduan me javë të tëra përpjekjet për të bindur Portën e Lartë, që të lejonte formimin e Lidhjes Shqiptare, si një organizatë kombëtare, e cila do të luftonte për të mbrojtur tërësinë territoriale të Shqipërisë. Por Porta e Lartë nuk u bind. Ajo lejonte vetëm formimin e Lidhjes Islamike, si një organizatë të myslimanëve të Ballkanit, e cila veç kësaj do të ishte nën kontrollin e Portës së Lartë. Por, gjatë dhjetëditëshit të tretë të muajit maj 1878, kancelari Bismark mblodhi fuqitë e mëdha në Berlin. Më 13 qershor 1878, u ven-

dos të mblidhej Kuvendi i Përgjithshëm i Shqipërisë, i cili themeloi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit.

Për sa i përket karakterit politik që do të kishte organizata, vëzhguesit e huaj vinin në dukje se delegatët që kishin ardhur në Prizren, qenë ndarë në dy grupe kryesore, sipas prirjes që kishin për t'u formuar, ose një Lidhje Shqiptare ose një Lidhje Islamike.

Sipas konsullit Pons, banorët myslimanë ishin për besnikëri ndaj Portës së Lartë, ndërsa bashkatdhetarët katolikë kërkonin një Shqipëri autonome.

Me një shënim të botuar nga At Zef Pllumi në parathënie e Lahutës së Malësisë (botim XVII) shkruhet se ... Abedin Pasha tue shfrytëzue politikën evropjane të kohës, që mbështetej mbi vetvendosjen e popujve apo mbi parimet evropiane, i tha Abdyl Bej Frashërit, që të thirrte Lidhja Shqiptare e Prizrenit, që shqiptarët të kërkonin të drejtat e vetëvendosjes. Mjerisht në seancën e parë ajo u emërua “Lidhja e myslimanëve të vërtetë”. Kështu thonë proces verbalet, se duam të shkruajmë historinë e vërtetë. Atë kushtrim në emër të islamizmit nuk e dëgjoji kërkush në botë, ndërsa në një seancë tjetër, në të cilën morën pjesë delegacioni i Shkodrës, z. Filip Çeka (Summa) në shtëpinë e të cilit banonte konsulli francez në Shkodër, parashitroi kërkesën, që ajo të quhej Lidhja Shqiptare e Prizrenit.

Kuvendi i përgjithshëm i zhvilloi punimet e veta në një nga sallat e medresesë, ndërtuar në shekullin XVII nga Mehmet Pasha, e cila ndodhet pranë xhamisë. Punimet u zhvilluan me dyer të mbyllura për publikun.


Si rrjedhim, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, edhe pse me 10 qershor 1878 nuk u shpall zyrtarisht si një organizatë shqiptare, pati që ditën e parë të saj një karakter politik. Karakteri patriotik dukej gjithashtu në detyrën që mori përsipër Lidhja Shqiptare e Prizrenit, për të organizuar rezistencën politike dhe ushtarake, duke mobilizuar vetëm shqiptarë, pavarësisht nga përkatësia e tyre fetare apo krahinore.

Shkodra i merrte vesh shumë shpejt ngjarjet e Prizrenit, zakonisht nëpërmjet qiraxhinjve që sillnin pothuajse çdo ditë lekë nga miqtë e shkodoranëve, por nganjëherë brenda ditës nëpërmjet telegrafistëve, të cilët bisedonin fshehurazi me njëri-tjetrin me alfabet mors. Nëpërmjet këtyre kanaleve lajmet arrinin deri te zyrat e konsujve të huaj, të cilët dalëngadalë filluan që ta kthenin fytirën e tyre nga Prizreni.


Nga raporti i konsullit Lipich hartuar më 15 qershor 1878, kuptohet se Shkodra ishte në dijeni për platformën e Lidhjes, prandaj qytetarët shkodoranë myslimanë dhe katolikë vendosën që në peticionin e tyre, i cili, sikurse u tha, u pajis me 380 nënshkrime, të mos shprehej besnikëria ndaj Portës së Lartë, por të theksohej vetëm interesi i Kombit Shqiptar.

Në peticionin e datës 15 qershor 1878, i cili kryesohet nga Daut Efendi Boriçi, ndër të parët nga pjesa katolike është edhe Filip Summa (Çeka).

Gjithashtu edhe Pashko Vasa ka theksuar se “... në Shkodër



Patente mbrojtje Filip Çeka (Summa) nga konsulli francez Hecquardi, në vitin 1854



Medalje Ari për Mikel Çeka (Summa), më 23 prill, 1895

Pasqyrimi i aktivitetit të familjes Summa vërtetohet edhe nga vulat e saj, të cilat kanë shërbyer për dokumentet zyrtare të autorëve të kësaj familjeje, të miratuara nga shteti otoman.

Lidhjet e dy vëllezërve Mikel dhe Filip Çeka (Summa) me konsullatat e huaja kanë shërbyer për një kohë të gjatë dhe kanë krijuar premisat për vlerësim personal të tyre.

Kështu, në vitin 1854 u lëshua një dokument, patentë mbrojtjeje për shtetasin otoman Filip Summa, e lëshuar nga konsullata franceze e asaj kohe në Shkodër,

Gjithashtu emri i familjes Çeka përmendet edhe në librin e pagëzimit të vitit 1737, shkruar nga famullitari i Tophanës Dom Pal Kamsi, në datën 18 qershor 1736 krahas familjeve të tjera katolike shkodorane.

Familja Çeka (Summa) pati lidhje të ngushta me personalitetet e konsullatës franceze. Kështu, sipas një dokumenti të shkruar me shkrim do të jepen disa referenca.

Në pagëzimin e Filip Çekës, nunë kanë qenë Gjorgjo De Grand dhe Maria Berte De Grand (konsulli dhe gruaja

Fuqitë e Mëdha u bindën përfundimisht se as Protokollit i Stambollit nuk mund të zbatohet me anën e presionit diplomatik. Anglia dhe Rusia propozuan një ndërhyrje ushtarake të përbashkët të Fuqive të Mëdha kundër shqiptarëve të përqendruar në kufi, por Austro-Hungaria dhe Gjermania e kundërshtuan. Më në fund fitoi qëndresa shqiptare. Pasi pranuan në parim të hiqnin dorë edhe nga protokollit i Stambollit, Fuqitë e Mëdha miratuan më 15 qershor 1880, propozimin e Anglisë dhe të Austro-Hungarisë për t'i dhënë Malit të Zi në vend të Hotit dhe Grudës qytetin bregdetar të Ulqinit së bashku me rrethinat e tij.

Dega e Shkodrës diti fare mirë që ta organizonte mbrojtjen e Hotit dhe Grudës, madje në këtë kohë qendra në Prizren e humbi rëndësinë dhe iu nënshtrua veprimeve të Shkodrës. Dega e Shkodrës përbëhej nga 25 delegatë shkodranë dhe kishin caktuar një komision ekzekutiv me fuqi të plotë. Kryetari i Shkodrës dhe i komisionit ekzekutiv ishte Daut Efendi Boriçi dhe anëtarët e komisionit ishin: Selim Çoba, Filip Çeka, Gjon Muzhani, Zef Simoni, Ibrahim Dragusha, Haxhi Age Drishti, Shaban Bushati e Selim Gjyzezi. Por vendimi i Fuqive të Mëdha për t'i lëshuar Malit të Zi Ulqinin me rrethinat e tij, shtroi përsëri detyrën e ngutshme të mbrojtjes si tërësi të atdheut, të cilit po i shkëputej një pjesë e rëndësishme jetike. Kështu u hartua memorandum i datës 19 qershor 1880 kundër copëtimit të tokave shqiptare.

Në qershor të vitit 1880, në kabinetet e Fuqive të Mëdha po rrihej problemi për t'i dhënë Malit të Zi toka në përfundim të liqenit të Shkodrës, kështjellen e Ulqinit bashkë me qytetin. Kjo ndodhi mbasi Kongresi i Berlinit kishte vendosur në fillim t'i jepte Malit të Zi tokat shqiptare të Plavës dhe Gucisë, por siç duket forcat ushtarake malazeze u thyen nga forcat vullnetare shqiptare që luftuan nën udhëheqjen e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Pastaj erdhi "kompromisi". Korti që zëvendësoi Plavën e Gucinë me tokat shqiptare të Hotit dhe Grudës. Të njëjtin përfundim pati edhe lufta për mbrojtjen e Hotit dhe Grudës. Shqiptarët luftuan me heroizëm për mbrojtjen e tërësisë tokësore të Atdheut.

Lajmi për dorëzimin e Ulqinit u bë i ditur në Shkodër edhe pse qeveria turke nuk e kishte marrë ende notën zyrtare për këtë. Rreziku që kërcënonte Ulqinin ishte biseda e ditës në Shkodër. Komiteti i Lidhjes për Shkodrën, së bashku me përfaqësuesit e degës së Ulqinit që erdhën për të kërkuar ndihma, hartuan planin e përqendrimit të ngutshëm të forcave vullnetare në Ulqin. Qeveria turke ngarkoi Hysen Pashën, i cili ishte Vali në Shkodër, që të ndërmjetësonte pranë parisë Shkodër, të cilët i njihte personalisht që t'ua mbushte mendjen popullit që të mos kundërshtojë dorëzimin e Ulqinit. Qysh më 27 gusht, ai i drejtoi Lidhjes në Shkodër këtë telegram: "Për së shpejti do të vijmë luftanijet e Pushteteve të mëdha për me i dorëzuar Ulqinin Malit të Zi, prandaj ju këshilloj për të mirën tuaj që pa humbur kohë të mbushni mendjen popullit me e dorëzuar shpejt Ulqinin. Nesër pres përgjigje, keni kohë e keni për detyrë të domosdoshme me u këshilluar."

Përgjigjja e popullit ishte kjo: Përmba-

jtja e urdhrit telegrafik që erdhi dje ju komunikue fjali për fjali popullit të përbam prej mysliman e të krishterë, por sikurse në protestat e kërkesat e paraqitura deri më sot Portës Lartë dhe këtë herë populli na përgjigjet se kërkush nuk e pranon që Ulqini t'i jepet Malit të Zi... me 28 gusht 1880 nga e gjithë parësia Shkodrës.

Hysen Pasha pa se në këtë mënyrë nuk mundi t'ia mbërrinte qëllimit dhe mendoi që të merrej vesh drejtpërdrejt me ta, me anë të aparatit telegrafik. Më 27 gusht, Ministri i luftës thirri parësinë e Shkodrës që të mblidhej në zyrën telegrafike ku u zhvillua bashkëfjalim telegrafik. Telegrafisti i Shkodrës i thotë atij të Stambollit: Adoni t'ju paraqes emrat e zotnive të Shkodrës që gjenden para aparatit? Zotnit e ndershëm po presin.

Pasha i përgjigjet: Ai i Stambollit akoma ndodhet në audiencë tek Sulltani, tani sapo erdhi Ministri, të cilët prej parisë gjinden pranë jush? Zotnitë që gjenden pranë aparatit janë: Daut Boriçi, Selim Efendi, Shaban Beu, Haxhi Lohja, Selim Gjyzezi, Ethem Kazazi, Ibrahim Efendi Hoxha, Ibrahim Efendi Dragusha, Osman Bektashi, Filip Çeka, Kolec Shiroka, Gjon Muzhani e Zef Simoni.

Biseda u zhvillua ndërmjet palëve, të cilat kishin pretendimet e tyre, por ministri turk i luftës me dinakëri u thotë: Nxitoni të dorëzoni Ulqinin, nesër pres përgjigje, e keni për detyrë të domosdoshme me këshillu ata njerëz nga populli që nuk e mendojnë se brigjet e detit të Shqipërisë e të Turqisë në Evropë do të rrihen me topa prej luftanijeve që janë mbledhë në Raguzë e Zoti na ruajt ka me u marrë nëpër këmbë nderi i myslimanizmit dhe i krishterimit.

Më 9 shtator 1880, mbas dreke, me anën e një shkresë të nënshkruar dhe vulosur, Lidhja refuzoi kërkesën e Ministrit të luftës. Më 14 nëntor 1880, Dervish Pasha urdhëroi me anë të shpalljes ndalimin e largimit për në Ulqin. Gjendja e shtetrrethimit, e vendosur që më parë, zbatohet me rreptësi të madhe. Në Shkodër, nëpër pika strategjike që çonin në Ulqin, u shtuan patrullat e shumta.

Për mbrojtjen e Ulqinit filluan të vinin në Shkodër vullnetarë edhe nga krahina të tjera. Poeti patriotik 20-vjeçar Filip Shiroka, i cili në këtë kohë ndihmoi çështjen kombëtare me shkrime si korrespondent i disa gazetave të Triestes, i frymëzuar nga qëndresa heroike e shqiptarëve në mbrojtje të Ulqinit shkroi poezinë patriotike "Në armë Shqipëri", ku ngre lart patriotizmin e popullit shqiptar dhe demaskon Kongresin e Berlinit që e quan turp të botës.

Presionet që Dervish Pasha bëri nga 7 deri më 16 nëntor 1880 ndaj Komitetit Ndërkombëtar të Lidhjes për Shkodrën, për të detyruar të dorëzonte Ulqinin, nuk dhanë rezultat. Për të shpejtuar dorëzimin e Ulqinit u angazhua konsulli anglez K. Grini dhe ai austro-hungarez F. Lipihi në Shkodër, të cilët, në marrëveshje me Dervish Pashën ushtronin trysni mbi Komitetin Ndërkombëtar të Shkodrës për ta bindur të hiqte dorë nga mbajtja e Ulqinit.


Përballë kësaj trysnie të Dervish Pashës dhe premtimeve të konsujve të huaj, më 17 nëntor 1880, shumë anëtarë të Komitetit Ndërkombëtar të Shkodrës deklaruan se hiqnin dorë nga qëndresa e armatosur në Ulqin. Ndërkohë edhe mjaft nga përfaqësuesit e kraut të moderuar

kishin kapitulluar para Dervish Pashës dhe patën shkuar aq larg sa ditë më parë kishin lajmëruar telegrafisht Kuvendin e Dibrës se nuk kishin nevojë për ndihma, pasi kishin vendosur të dorëzonin qytetin. Kapitullimi i tyre shkaktoi revoltimin e atdhetarëve shkodranë, të cilët formuan një komitet të ri të Lidhjes Shqiptare për Shkodrën. Në komitetin e ri, i cili u ngrit më 19 nëntor 1880, hynë partizanët e vulosur të mbrojtjes me armë të Ulqinit si: Selim Çoba, Isuf Sokoli, Filip Çeka, Fetah Dragusha e të tjerë.

Por ngjarjet u zhvilluan me shpejtësi të madhe, përçarja në udhëheqjen e Lidhjes dobësoi forcat e saj ushtarake, sidomos me ardhjen e vullnetarëve të tjerë. Komiteti i Ri i Shkodrës nuk pati kohë të mobilizonte popullin dhe të organizonte qëndresën e armatosur kundër ushtrisë osmane. Tre ditë më vonë, më 22 nëntor 1880, ndërsa Shkodra nuk e kishte kapërcyer ende krizën e brendshme politike, Dervish Pasha i dha urdhër ushtrisë turke të fillonte marshim për në Ulqin. Atë ditë ushtritë turke u ndeshën me forcat shqiptare të Kodra e Kuqe afër fshatit Klezna. Në fillim, në Kleznë qenë përqendruar gati një mijë luftëtarë shqiptarë, të përbërë nga vullnetarë shkodranë, ulqinakë, hotjanë, prizrenas, tetovarë, kelmendas e të tjerë të udhëhequr nga vetë shtabi ushtarak ku merrnin pjesë: Isuf Sokoli, Mehmet Beu, Abdyl Hoti, Fetah Dragusha, Filip Çeka, Gjon Deda e të tjerë.

Në fillim vullnetarët shqiptarë i sprapsën ushtritë turke, por më vonë, pasi aritën reparte të tjera osmane të pajisura me artileri moderne, forcat shqiptare u thyen. Komandanti i tyre, Isuf Sokoli, u plagos rëndë dhe pak më vonë vdiq. Pasi ushtria shqiptare u thye, forcat turke vazhduan marshimin dhe hynë në Ulqin më 23 nëntor 1880 dhe më 26 nëntor 1880 ia dorëzuan ushtrisë malazeze.

Së bashku me dorëzimin e Ulqinit mori fund dhe çështja e kufijve veriorë, e cila kishte shqetësuar për gati 30 muaj, jo vetëm perandorinë osmane, por edhe diplomacinë evropiane. Megjithatë, edhe pse çështja e kufirit turko-malazez u mbyll, lufta që zhvilluan shqiptarët kundër shantazhit brutal të Fuqive të Mëdha dhe ndërhyrjes ushtarake të Portës së Lartë la përshtypje të thella në opinion publik të Evropës. U ngritën zëra proteste kundër




Memoranduni drejtuar fuqive të mëdha

politikës së Fuqive të Mëdha, të cilat vendosën luftanijet për të shtypur të drejtat kombëtare të popullit shqiptar. Veç kësaj, sapo përfundoi dorëzimi i Ulqinit, Fuqitë e Mëdha filluan të largonin luftanijet njëra pas tjetrës, duke i dhënë kështu fund demonstratës navale. Pas thyerjes së rezistencës shqiptare, Fuqitë e Mëdha vendosën ta zgjidhnin çështjen e Ulqinit, duke caktuar sa më parë në terren piramidat e kufirit të ri turko-malazez. Mbas përfundimit të dorëzimit të Ulqinit, ku mbeti i plagosur dhe më pas vdiq luftëtari dhe patrioti Isuf Sokoli, kushëri i një trungu me Filip Çekën, ky i fundit jetoi në Shkodër dhe në vitin 1895 vdiq nga një goditje në zemër dhe u varros tek varrezat e Rrmajit, në varrin familjar të vjetër të familjes. Ai ishte i martuar në vitin 1844 me vajzën e Gjergj Shirokës (shënim nga ditari i Mustafa Boriçit), por nuk pati fëmijë.

Me rastin e 100-vjetorit të Lidhjes së Prizrenit nga Presidiumi i Kuvendit të Republikës Socialiste të Shqipërisë, u dekorua me urdhrin "Për veprimtari Patriotike të klasit III".

Në shtator të vitit 1989, në kujtim të patriotit Filip Çeka është vendosur një pllakë përkujtimore me këtë motivacion: "Në këtë shtëpi ka lindur dhe jetuar atdhetari Filip Pjetër Çeka, ndër autorët më aktivë të degës Lidhja Shqiptare për Shkodrën, 1878-1880".

Engjëll Çeka



Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, me vendim nr. 5746, datë 5.6.1978, i ka dhenë Filip Pjeter Çekes, pas vdekjes, "Urdhrin për veprimtari patriotike", të klasit III, me motivacion: "Si aktivist i dalluar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit të viteve 1878-1881 ka dhenë kontribut me pjesëmarrjen e tij në luftën patriotike të masave popullore për mbrojtjen e tërësisë së tokave shqiptare dhe për çlirimin kombëtar.

Pasoja e drogës në trurin e adoleshentëve

Para dhjetëra vitesh, është menduar se, truri i të rinjve, është ndryshe nga ai i të rriturve. Kjo “hipotezë”, është vërtetuar shkencërisht dhe, nuk është më vetëm “hipotezë” por, një e vërtetë. Shkencëtarët, para ca vitesh, mendonin se truri e përfundon rritjen e tij, kur fëmija mbush moshën dhjetë – dymbëdhjetë vjeç. Sot dihet diçka krejt tjetër. Pjesët e trurit, të posaçme për vetëkontroll, ndjenja, aftësinë e të gjykuarit dhe organizim, e përfundojnë zhvillimin e tyre të plotë vetëm në moshën 20 deri në 22 vjeç. Duke u nisur nga ky përfundim shkencor, truri i të rinjve, në fazën e zhvillimit të tij, është shumë i rrezikuar. Ashtu si tek fëmijët e moshës, nga një deri në tetëmbëdhjetë muaj, edhe tek truri i të rinjve ndodhë një mbiprodhim i masës gri të trurit. Ndërkohë që fëmijët e vegjël nuk e kuptojnë dot se çfarë duhet të mësojnë dhe si duhet ta shfrytëzojnë këtë periudhë, për të regjistruar sa më shumë, të rinjtë kanë njëfarë kontrolli në këtë fazë. Gjatë kësaj periudhe mbiproduhese, në trurin e të riut krijohen të gjitha qelizat e nevojshme, për lidhje dhe komunikim me botën e jashtme. Paralelisht me këtë, ndodhë edhe një fenomen tjetër, i cili mund të mendohet i dëmshëm. Të gjitha qelizat, të cilat nuk hyjnë në përdorim gjatë kësaj periudhe, që nuk aktivizohen por janë pasive, asgjësohen nga vetë truri. Ky asgjësim është i parikthyeshëm. Nëse të rinjtë, e kalojnë kohën në divan, me telefonin e dorës, duke lozur, apo para televizorit, qelizat vazhdojnë vdekshmërinë e tyre të lartë. Nëse truri, në moshën 20-22 vjeç, është vetëshplarë nga qelizat e “tepërta”, nuk i kërkon më ato dhe për gjithë jetën nuk ndryshon gjë. Njeriu mbetet në një masë të konsiderueshme i paafte, për punë dhe

komunikim social. Është fare e lehtë për mësuesin që të dallojë nxënësit, me prejardhje fshatare, nga ata të qytetit. Fëmija nga fshati, nga pamundësia që ka pasur për kontakte me mjedisin dhe botën rreth vetes, ndjehet inferior ndaj atyre të qytetit, dhe shfaq mangësi të dukshme njohje, komunikim dhe sjellje. Qelizat e tij nervore, nuk e kanë njohur një program të tillë, dhe për rrjedhojë, nuk e kanë regjistruar. Shpesh ndodhë që prindët, ju lutën fëmijëve të tyre për t’i ndihmuar diçka në kompjuter. Prindit e kanë të vështirë që ta mësojnë kompjuterin, kanë vdekur qelizat për një gjë të tillë. Ndërkohë që fëmijët e moshës katër apo pesë vjeç bëjnë mrekullira në telefonin e dorës, gjyshi, zor se mund ta përdorë, telefonin e thjeshtë, për t’u përgjigjur dhe thirrur. Fëmijët, nga mosha dy deri në gjashtë vjeç, mund të mësojnë njëkohësisht, minimumi tri gjuhë të ndryshme, pa u lodhur fare. Të rriturit nuk e kanë këtë aftësi, kanë vdekur qelizat e përshtatshme për këtë gjë. Truri është një “vrasës” i pamëshirshëm i vetvetes, i qelizave të panevojshme dhe nuk i rriprodhon më ato. Është detyrë e posaçme por, dhe shumë e vështirë e prindërve që, gjatë kësaj periudhe, t’i aktivizojnë fëmijët e tyre me veprimtari të ndryshme, duke i nxitur dhe guximuar ata, për të qenë sa më aktivë dhe të shumanshëm, para se të vendosë truri për “ekzekutimin” e miliona qelizave “parazitë”. Mekanizmi i ndjenjave tek të rinjtë është ndryshe nga ai i të rriturve. Mendohet se akoma nuk ka përfunduar së ndërtauri. Ndjenja e frikës, guximit, zemërimit, rebelizmit, përgjegjësisë, janë në një masë krejt tjetër nga ato tek të rriturit. Reagimet e tyre janë ndryshe nga ato që presin të rriturit. Ndërkohë

që të rriturit i analizojnë ndjenjat me pjesën frontale të trurit, aty ku është “bulla sociale”, të rinjtë i perceptojnë ato me amygdalën. Detyra e pjesës frontale të trurit është të menduarit logjik, vendi i ekuilibrit të ndjenjave me vetëkontrollin. Amygdala kontrollon, mbi të gjitha, sjelljet instinktive të individit, shpejtësinë e reaksioneve, atyre që e vënë njeriun në veprim në raste rreziku, pa pasur nevojë të mendojë. Truri i mesëm është qendra e ndjenjave të jetës dhe e arrijnë zhvillimin e plotë në moshën 22 vjeç. Shkencëtarët e trurit, thonë se, të rinjtë, reagojnë para se të mendojnë, ndërkohë që të rriturit e kanë aftësinë e të menduarit para se të reagojnë. Kjo vërteton faktin që, përse të rinjtë janë aq të ndikuar në vendimmarrjet e tyre nga ndjenjat, duke na befusuar me surprizat e tyre. Për të rriturit, në rastet e veprimeve të nxituara dhe të gabuara të të rinjve, është normale pyetja: Si e bëre ti këtë gjë? Por, po aq normale është edhe përgjigja e të rinjve: Nuk e di! Ata vërtetë nuk e dinë. Të rinjtë mendojnë ndryshe, madje shumë më ndryshe nga të rriturit, në një mënyrë dhe art krejt tjetër, befusues. Amygdala reagon automatikisht, para se i riu të mund të timonojë situatën, për të vendosur, gjykuar apo kontrolluar diçka.

Armiku më i rrezikshëm për të rinjtë, gjatë gjithë kohës së zhvillimit të trurit, deri në formimin e tij të plotë, janë lëndët helmuese, alkooli dhe droga. Nëse të rinjtë, gjatë kësaj periudhe, konsumojnë në mënyrë të pakontrolluar drogë dhe alkool, rrezikshmëria e dëmtimeve të pariparueshme të trurit, është shumë më e lartë se tek të rriturit. Rreziku tjetër i madh është se, sa më shpejt që të rinjtë fillojnë me konsumin e drogës dhe alkoolit,

aq më aktual është rreziku për të kaluar në vartësinë e tyre. Fillimisht, droga dhe alkooli godasin qendrën e “busullës sociale”, ku perceptohet bota, vjen mendimi logjik dhe kontrollohen fjala dhe veprimi. Prandaj, i dehuri mendon se mund ta drejtojë makinën dhe i droguari thotë se shkolla është kohë e humbur. Perceptime jashtë realitetit. Kjo tregon se, është dëmtuar pjesa frontale e trurit, vendndodhja e ndjenjave. Shpesh qëllimi i drogë dhe alkoolpërdoruesve është dëmtimi i kësaj pjese të trurit. Në rastet kur kjo preket rëndë, njeriu humbë ritmin e frymëmarrjes, zemra fillon të rrahë jashtë normave dhe mund të ndodhë edhe vdekja. Nëse njeriu e ndërpret konsumin e drogës dhe alkoolit, fillon shërimi “brendshëm” i trurit. Në fillim normalizohen funksionet automatike: zemra dhe frymëmarrja, gjumi dhe oreksi. Pastaj rikthehen ndjenjat por, jo aq shpejt në masën normale. Madje tek disa zgjatë aq shumë sa nuk e durojnë dot dhe rikthehen përsëri tek alkooli dhe droga. Për shumë të rinj të cilët nuk e përballojnë dot kohëzgjatjen e rikthimit të ndjenjave, është mirë që të shpëputen nga mjedisi “helmues” dhe të dërgohen në vatra të sigurta, pa drogë dhe alkool. Kështu që u hiqet mundësia e vendimmarrjeve jashtë kontrollit të ndjenjave. Si rregull, trurit deri në shërimin e plotë, i duhet gjysma e kohës që përdoruesi ka konsumuar drogë apo alkool. Nëse ai ka konsumuar të tilla lëndë për dy vjet, trurit i duhet një vit. Në të gjitha rastet, përdorimi i dhunës dhe keq sjellja me viktimën e alkoolit dhe drogës, janë të pasuksesshme dhe madje të dëmshme. Duhet kërkuar ndihma e mjekut.

Leke Imeraj,

përkthyes, shkrimtar e publicist

Kur dielli kulturës është ulët, xhuxhat shëmbëllojnë të mëdhenj!

NGA BESI BEKTESHI

Sigurisht që nuk është një shprehje e imja, por e dëgjuar si aforizëm nga Karl Kraus ose gazetari shkrimtar aforist austriak, në gjysmën e parë të shekullit 20-të. Vjen nga Konfuci që thotë “kur hijet tona të duken shumë të gjata, ta dini se dielli është në perëndim!” Në fakt “dielli kulturës” kaq ulët, nuk është hera e parë që është në botë dhe Evropë, por në Shqipërinë e sotme në kohë rrjetesh dhe komunikimi global, teknologjie dhe arritjesh të stërmëdha komunikimi, ky “diell është ulur me faj” nga “dogmaxhinjtë” e perversitetit moral politik dhe filozofik. Ky diell që është ulët në kulturën tonë, po shkakton një rënie pikiatë në momentin tonë kulturor. Padiskutim që është një fatkeqësi! E pikërisht në këtë “diell të ulët kulturor” po ngjiten lart dhe duken apo imponohen të pranohen si të mëdhenj lartësi nga më të ulëtat, morale, filozofike, mediatike dhe politike! Po bëhet shpesh herë me qëllim kjo gjë, për të pasur politikisht dhe pastaj ekonomikisht përfitim një kastë politike fajtoresh dhe e korruptuar. E ky “diell kulturor” ulët, po i mban në pushtet shumë gjatë një dorë kopukësh mediokriteti historik, politik

dhe në trashëgimie, por dhe në qytetërim në Shqipërinë tonë të shkretë. Është pikërisht kjo shoqëri, tashmë në hullinë e rrëzimit në çdo dhjetë vjet, që po pranon një fatkeqësi të tillë kulturore me pasoja të mëdha politike. Po po, është ciklike një rrëzim kulturor, me prodhime të shëmtuara dhe inflacion prodhimi mediokër dhe moralisht të shëmtuar. Ky prodhim duket në televizione me modelet “real TV” ku imoraliteti dhe kodet e etikës thyhen, nuk propagandohet morali, por ç’moralizimi dhe ku propagandohet padobia dhe injoranca në të shprehur dhe të shkruar, por dhe në të menduar. Natë për natë dhe ditë për ditë, në çdo orë të ditës. Nuk prodhohen emisione për edukim në dhe për punë, por propagandohet dembelizëm dhe kotësi amorale në mënyrë dramatike. Perversitet fjalësh dhe komunikimi, që po bën pis moralin dhe të një brezi që rritet. Botim librash në inflacion autorësh mediokër dhe nga njëherë perversësh moral, që kanë si qëllim të shesin kur bëjnë batuta të ndyta dhe që nuk kanë asnjë rregull drejtshkrimor normal. Promovime idiothe autorësh, që ia kalojnë për nga “talenti” dhe Shekspirit në drama dhe Heminguejtit në romane, apo Erih Maria Remark, në talentet e tyre në promovime idiothe, ku

asnjë nuk ka lexuar librin, por flet me diti-rambe vetëm se është mbledhur të thotë diçka për autorin! Sigurisht nuk është e gjithë situata kështu por... Po kështu në pikturë dhe artet pamore që përveç njerëzve të famës dhe punës artistike plot nder, mblidhen pastaj mitomanë arti dhe njerëz të artit të shëmtuar, pa asnjë art brenda, por me lekët që nuk mungojnë te mediokrit, për të bërë promovime veprash që shëmtojnë kulturën artistike. Nuk ka prodhim esencial dramash qytetare dhe urbane në sensin e problematikës, por mitomani artistikisht të vendosur në krijim. Vepra sa më lirë e realizueshme, por me përmbajtje tipike të “diellit ulët” që tregon xhuxhin si gjigant arti! Vepra që të lodhin dhe komunikim, që të shëmton artin sa do të kesh durim. Mungesë prodhimi realisht artistikisht avangard mendimi dhe problematike në kohë dhe sidomos te ne! Drama që revokojnë kohë jashtë nesh dhe që merren “me abeshin dhe nuk këqyrin hallin tonë!” Është rrëzuar komedia dhe nuk jeton më humori moralisht normal, por mbizotëron sharja dhe fjala e ndytë! Po këto të bëjnë të qeshsh në art. Nuk krijojnë dot art të së qeshurës normale dhe moralisht korrekte, etikisht normale. Po ashtu në muzikë ku “xhuxhat” që

kanë lek, bëjnë dhe këngën sot. Atë këngë plagjiaturë, imitim, ato tekste shpesh herë idiothe që po bëjnë dhe autorë të lartë, por që përshtaten me këngëtarë “xhuxh –ma –xhuxhë” që ose “kanë lek ose shalët jashtë!” Xhuxhat në kulturë përfitojnë nga dielli ulët. Përfitojnë në muzikë dhe në artin e kohës duke prishur trashëgimi dhe duke sjellë kakofoni të shëmtuar, përshtatje perverse me tregun akoma më keq se sa “dielli ulët!” Po ju imponojnë të gjithëve kulturën banale dhe atë mediokër apo hajdute, që kanë si model ato që duken gjigantë kur dielli i kulturës është pothuaj duke perënduar. Një gjendje të tillë e përforcon dhe kërkon klasa politike korruptive dhe injorante si dje dhe sot për gjatë 30 viteve! Ajo përpara tyre, ishte dogmatike dhe e ideologjizuar, kjo e sotmja imorale dhe politizuar përveç se korruptuar! Ju leverdis një gjendje e tillë ku kultura dhe arti, janë kështu poshtë dhe xhuxhët e kulturës janë tashmë lart, të pasuruar dhe që imponojnë imoralitet dhe amoralitet njëkohësisht! Po vrasin shumë kulturalisht këtë vend. Po vrasin dhe nuk po ndalen. Kurse shoqëria jonë i lejon. Po po sepse është kaq sëmurë sa po i lejon. Kjo është fatkeqësi. Një marrëzi kolektive që po pranon çoroditjen në vend të orientimit urban qytetar në Shqipëri. Po sëmuremi kaq shumë, sa është pastaj shumë e vështirë kura më vonë, kur të kuptohet sa keq është situata.

Epoepa e Dacit

“Kalendari i Veprës Pijore”, një revistë me vlera të mëdha kulturore për literaturën e historinë tonë “e harruar”, sy për sy qëllimisht edhe në shekullin XX në Diktaturë dhe në Demokraci ...

Në numërin e vitit 1922, tetuer ja çfarë poeme satirike flen e mbuluar: “Epoepa e Dacit Bolshevik”!

Ma kishte lënë prindi im me porosi dhe ndonjë shënim, krahas edhe disa surprizave të tjera që do t'i botoj ...

Pa i hý komenteve të tjera, po e botoj me fotoskanim. Me sa më ka kumtue autoriteti Willy Kamsi, ky autori anonim mendohet të jetë Ndoc Vasija... dhe këtë botim me kohë ia pata premtue një mbese të Gjoshë Vasisë...

Epoepa e Dacit

Rrnoftë e kjoftë daci,
Shtasë bujarijet,
Qi me veprime
Të mdhaja urtijet
Ë kshilla të larta
U paraqitet
Shum filozofve
Në do shkollna dritet,
Hyll idealit
Bash i moralit.
Rrnoftë e kjoftë daci,
Aj djalë prej djalit.
I dlirtë, i bukur,
I butë kuer qaset.

Tuj ngrehun bishtin
Furet e rraset
E din se ktune,
M'u fitue buka.
Ma fort se të kenunit
Vin qefi e duka
Për faqe të bardhë
Si në zheg si në mardhë.

Rrnoftë e kjoftë daci,
Qi din me i ardhë.

Se çë dimë natyra
I bani, shife!
I fali lkuren
Veshun në kadife,
Si bishet të vogel
Ftyren e mledhun
Mustakë sherbeza
E bisht të perhjelun
Synin djamant,
Politikant ...

Rrnoftë e kjoftë daci,
Djalë elegant.

Si Veletrikut
Leshi i qet shkundi
Naten dy xhixha
Janë syt e ti:
Shpejt kacaviret,
Hidhet çek fek
E me sy të metun
Kcen diku tek,
Zor per me ikë
Se ka asnji pikë.
Rrnoftë e kjoftë daci,
Të tanë gjmnastikë.
Në vend të brushës e të krahnit
E brilantinet
Ka kamët e giuhen

Qi lmohet shpinen.
Njishtu prej vedit
I lpm e i krehun
Pa ba shpenxime
Me mustakë të ngrehun,
Prej salet të vetë
Aj del në gjytet.

Rrnoftë e kjoftë daci,
Me toilet.

Edhe muzhika
I shkon per piri;
Ja shurdhon veshin
Setsillit niri
Kuer me ato nota
Kndon porsî saze
Disa mekame
Neper pallaze,
Thue se ndonji qen
Shtjelmin ja ven.

Rrnoftë e kjoftë daci,
karadyzen.

Me i himun në hater
Gjithkuj dishron,
Por mik me zemer
Kerkuj s'i shkon,
Per evarina
Së çan fort kryt
Mikut e anmikut
Me i nxjerrë don syt,
Gerdhishtë pa të veshitir
Hir e pa hir,
Rrnoftë e kjoftë daci,
Kaq zëmerrmire.

Sjellë për botim
Agron Luka, mars 202



Lamtumirë mjeku Thomà Dardeli

Me hidhërim të thellë mësova për ndarjen nga jeta të mjekut Thoma Dardeli!

Kush ishte mjeku hero që njihej më shumë në Hungari, se në Shqipëri?

Mjeku Thoma Dardeli lindi në fshatin Muzine-Sarande, me 1932. Shkollën fillore e mbaroj në fshatin e lindjes, ndërsa tetëvjeçaren dhe shkollën e mesme mjekësore në Tiranë. Ka kryer studimet e larta për mjekësi në Budapest-Hungari, me rezultate të shkëlqyera, në vitin 1951-1956. Ka marre pjese aktive ne Revolucionin Antikomuniste Hungarez 1956. Në fillimin e dhjetorit 1956 kthehet në Shqipëri bashke me studentet e tjerë që ishin në Hungari dhe ishte nen mbikëqyerien e strukturave të Sigurimit të shtetit. Për pasoj arrestohet dhe dënohet me 18 vjet burg, me punë të detyrueshme, duke kryer 11 vite. Kalvari i vuajtejeve të tij nuk kanë të sosur, se kudo që shkonte vezhgohej nga siguri-mi.

Dërgohet si mjek në zona të thella të vendit si, në Fushë-Arrës, Terpan, Buzë, Dukagjin,

Vig-Mnele e të tjera. Sigurimi sajonte akuza nga më të ndryshme, në vizitat që bënte tek familjet e sëmura, ku akuzohej se kishte marre ryshfete, si: një lëkurë dele (Post) apo i kishin mbytur

një pulë.

Në muajin korrik 1981 e demaskojnë para popullit, në fshatin Vig-Mnele. Akuza ishte si pjesëmarrës në Revolucionin Antikomunist Hungarez, me 23 Tetor 1956. Ishte ky shqiptar me bluzë të bardhë, që ndihmoj të plagosurit gjete demonstratave dhe tërheqin zvarre të monumentit te Stalinit para Radios, rruga “Brody Shandor”, nr. 5, në Budapest.

Në korrik 1991 ka themeluar në Shkodër Shoqatën e Miqësisë “Shqipëri-Hungari”. Me iniciativën e tij e miratimin e këshillit bashkiak Shkodër ka marre emrin Rruga “Revolucioni Antikomunist Hungarez” pranë stacionit të trenit. Ishte anëtare i dy shoqatave antikomuniste hungareze. Në shtatorin e vitit 2007, përfitova një vize një javore nga ambasada Hungareze si gazetar i TV “Rozafa”, ku përgatita një dokumentarë. Ishte një udhëtim i vështirë pa përkrahje financiare, mjeku udhëtonte në tren, tre dite udhëtim, se linja e avionëve ishte e pa përballueshme. Ishin miqtë hungarez, që na hapnin dyert gjate ditëve



të qëndrimit ku u njoha me universitetin, miqtë dhe ngjarjet historike.

Me 23 tetor 2006, me rastin e revolucionit antikomunist hungarez, është dekoruar nga Presidenti Hungarisë me medaljen “Hero i Lirisë”. Gjate viteve të demokracisë mjeku Dardeli nuk ndali veprimtarinë e tij, për të krijuar lidhje miqësisë mes Shkodrës e Hungarisë. Punoj për zhvillimin e turizmit, grupeve artistike e ndihmat që u afronte personave për vizita të specializuara ne Hungari. Jetoj për shumë vite në Shkodër, duke jetuar tek Shtëpia e “Pionierit” dhe më vonë tek rruga e “Kavajës”, në Tiranë. Botoi librin, me titull “Revolucioni Antikomuniste Hungarez-1956”, në Tiranë, me 2015.

Punoj dhe beri gati për botim fjalorin “Shqip-Hungarishte”.

Kalvari tij plot vuajtje e beri ketë intelektual të gëzoj autoritet në ndihme të të sëmurëve, në veçanti në kujdesin ndaj të burgosurve gjate qëndrimit në burg.

I shprehim ngushëllime bashkëshortes, Gjystina Dardeli (Shestani), familjareve dhe miqve të tij kudo që ndodhen në Shqipëri dhe jashtë saj!

Lamtumire mjeku Thoma Dardeli!
Shpirti i tij pushoftë në paqe!

Zef Nika, Bruksel

*** POEZI *** ** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI ***

YLLI I ALPEVE THONË U SHUE

14 gushti dymij e njizet
Ala djelli s'kishte shkrep
Telefoni lajm po jep
Ç'asht ky lajm hejmedet
Zana e malit po pisket
Kush ndigjoi me dhimje e priti
Ushtoi Cemi, gjam muer Veleçiku
Edhe valët i pushoi Drini
Shpendet e malit ditë vajtimi
S'po këndon zogu as bylbyli
Dhe shqipojat pushuen fluturimin
Për zadhanësin e dashamirin
Muerën Alpet hije të randë
Maja – majës, lajm i kanë dhanë
Çka me thanë, a me diftue
Në befasi pa pritë mendue
Ylli i Alpeve, thonë u shue
Ra ndriçimi, që shndriti motit
Pushue zemra e të mirënjoftunit
Historianit e studjuesit
Të paharruemit Kol Prognit
Merturi e Nikaj ditë mortit
Thonë si erdhi kjo fatkeqësi
Sëmundje e randë pandemi
Të gjithë botën e ka përfshi
Vdekje të randa plot merzi
S'pranon pjesmarrje në kortezi
Lind e rritë ne Salcë të Merturit
Bashkëfshatar i Prel Tullit
Si dy shqipe rrinë në flamur
Kalitë shekulli në luftë e punë
Prela në luftë, Kola shkencë e kulturë
Simbole nderit me lavdi
Të përjetshëm në histori
Lindi në familjen shpirt kombëtare
Gjenetikisht në trashigimin familjare
Historikisht, trime bese e bujare
Që në vogli kishte mendue
Lind dishira me u shkollue
Në shpirt e mendje mush me dëshirë
Me studjue gjeografinë
Baba Prel e nana Linë
Si gjithmonë prindi për fëmijën
Me dëshirë e me shpresë
Ja miratuen këtë kërkesë
Vazhdoi mësimet në universitet
Përfundoj me sukses
Vazhdoi jetën me progres
Shpirtin e zemrën shumë bujare
Ku bashkëjetoj dëshira e madhe
Me studjue Alpet shqiptare

Kjo ambicje shumë e ngacmoi
Deri sa atë e realizoi
Shpirtënisht Alpet i dashuroi
Në jetën me nxënësit përparoi
Shkëlqej autoriteti i tij burrënor
Për punë në Alpe, shoqëni e shkollë
Për meritë e thirrën "profesor"
Shërbej në disa zona në malësi
Zona të ndryshme në veri
Prej Tropoje e deri n'Kelmend
I nderuem në çdo vend
Mori emnin e madh studjues
Me ambicje shumë hulumtues
S'përfill lodhje, natë as ditë
Studjoi Alpeve gjithë bukuritë
Për klimën e zhvillimin bimor
Shpellat shekullore, majat me borë
Kreshta e lugina, e pyjet madhor
E fushat me lule plot aromë
Studim madhor, me aftësi e përgjegjësi
Të shoqënueme me fotografi
Dhe kafshëve të egra dhurue randësi
N'ato alpe ishin gjallëri
Dhanë natyra për jetësi
Ishte dëshira e zemrës tande
Bukurinë e Alpeve vepër i bane
Ishin simbolet e krenarisë madhe
Vlera të alpeve shqiptare
Ti ishe e mete studjuesi madhor
Veprat e tueja jetojnë në artin shkencor
Ti u bane dishmitar i vlerës jetës
Ligjërove realitetin e të vërtetës
Të asaj të pa studjueme
Në natyrë të ekzistuese
Shkëlqeve si ylli i ylberit
Gjeograf studjues i nderit
Në randësinë e vlersimit
U bane feneri i ndriçimit
Shetite Alpet anë më anë
Afro 7 mijë km në kambë
Objekt pa shijue s'ke lanë
Në ato male me shkami, e lugina pyjore
Në kohë me shi e furtunë bore
Kurr udhëtimin s'e dredhove
Alpeve ju ke dhanë vler madhore
Ti studjues i madh dhe i pari
U bane ciceroni e dëshmitari
Vlerësuesi e mendimtari
Mendjen e mundin, aty i shkriue
Për nderim i quejte vendlindje
Jetës i dhurove shumë kujtime



Pasuni me shkrime e botime
Të sistemue me mendime e kujtime
Originale të natyrës vërtetë
Shtëpinë e ktheve në bibliotekë
Thesar vlerash qëndron në jetë
Në studimin e madh cilësor
Me aparat mbi sy, e penën në dorë
Qindra e mija kopje ke përdor
Fotografi bardh zi e me ngjyra
Me bukurit, që të dhuroj natyra
Bukur i përpunove e sistemeve
Me vullnetin shpirtëror na i dhurove
Janë pjesë e zemrës e mundit
Që i dhurove dhe Nikaj – Merturit
Na ke lanë shume dhurime
Në realitetin me fotografi e botime
Në shpirt e zemër në pavdeksi
Nikaj Merturi në përparësi
Vendi ku fillove jetësi
Në Mërtur pate gjallëri
Me vllazën, motra e kushëri
Nipa e mesa e kushëri ni
Që kaluet gëzime e vështirsi
Me gra burrnesha, e burra si rrufeja
Gjithmonë gati ku i thirri beteja
Të vlersuem për trimëri e përparim
Për kulturë e shkollim
Të punoj shpirti, mendja e dora
Ngrite flamurin ku veton bora
Emnin e skalite në shkamb e gur

I përjetësuem: Alpe - Kol – flamur
Çdo studjues, turist apo kambësor
Në ato Alpe do të udhëtojnë
Ato simbole do t'i nderojnë
Se janë vlerat e kombit tonë
Administrove vlerën, vullnetin e mundin
Për Alpet e Tropojës, e Nikaj - Merturin
Prej në Kelmend e në Dukagjin
Me sineritet, i pasqyrove me vlersim
Na ndërgjegjësove në respektim
Ti ishe e mete studjues i madh
Për ne metesh aktual
Vlera të ngriti në pedestal
Nikaj – Merturi të nderoi me titull të madh
Në yllin e art me ideal moral
Vitet e motet, vinë e ikën
Vlerat e kujtime, gjithmon rriten
Bane punë e botime me cilësi
Nikaj – Merturin në monografi
Bashkë me Alpet, udhëtojnë në histori
Meritë e Kol Prognit në përjetësi.
Jo - jo nuk ke vdekun
Je tjetërsue në vepër
Do të jetosh në shekuj.

Pjetër Gera,
Janar 2022, Bruksel

REDAKSIA

Kryeredaktore: LUIGJ SHYTI

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi Botimin:
Gjergj Demaj